

Shqipëri, gëzuar festën e pavarësisë dhe të çlirimit nga mot!



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 205, Nëntor 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Historia e Shkodrës dje dhe sot

Shkodra: qyteti që prej shekujsh njihet si djepi i kulturës dhe civilizimit të lartë brenda trojeve etnike shqiptare, prej shekujsh qëndron e gjalle e plot dinjitet i rrethuar nga vargmalet lindore me Cukalin hijerëndë, Kështjellën Legjendare "Rozafa", Liqenin Labeat, pasurinë e pashtershme të Shkodrës si dhe fushat e tejzgjatura deri rrëzë Alpeve të Veriut. Historia e saj është e mbushur me ngritje dhe ulje ndër shekuj. Ajo gjithnjë ka qenë në qendër të vëmendjes gjatë gjithë historisë nacionale shqiptare. Shkodranët, kanë qenë ndër shekuj ndera dhe lavdia, të parë në të gjithë këndvështrimet, duke zënë në këtë mënyrë një vend nderi në histori. Do të mundohem që të cek nga pak majat e krenarisë së qytetit dhe të vetë banorëve të saj ndër shekuj, duke u bazuar në shumë burime historike, që janë dëshmi e mbijetesës së lavdishme të zonës dhe qytetit, të vetë banorëve vendlindur kulturëdashës. Shkodra, ky qytet i lashtë 2500-vjeçar, nga qendrat më të shquara qytetare të Shqipërisë ...



## Dr. Ahmet Osja-Mjeshtër i Madh, Ajka e Patriotizmit dhe hambari i dijeve njerëzore

Ahmet Maliq Osja vetëm fizikisht nuk është më midis nesh. Ai ishte dhe mbetet në kujtesën kolektive të shqiptarëve kurajozë si një pishtar i pashuar. Në këtë kujtesë janë gjasat se do të jetojë për një kohë të gjatë ky njeri i urtë dhe i zgjuar i qytetit të Shkodrës dhe i gjithë Shqipërisë. U nda prej nesh në një ditë kur pranvera është afër. Se do të vinte kjo ditë sekush prej nesh e dinte. Por, që të vinte aq shpejt e papritmas si një britmë në boshllëk kush prej nesh e dinte. Kjo, siç mend, ndodh, ...

## “KUJTIMET E NJË USHTARAKU” NJË JETË NË SHËRBIM TË ATDHEUT

- Bashkëbisedim me zotin Ndue Sanaj -


I dashur Ndue, mbas një pune disa vjeçare, më në fund i shkrove kujtimet e jetës dhe punës suaj ushtarake, i botove në një libër, me një paraqitje mjaft serioze, për të cilat jo pak me thoshe, se jam duke punuar të hedh në letër kujtimet e mia më mbreslënëse të jetes sime ushtarake, prej 45 viteve dhe të thosha mirë bën. Në vleresimin tim, të them me bindje të plotë: Të lumtë mendja e dora për këtë arritje të madhe, e cila është diçka ndryshe nga botimet e zakonshme.

Zoti Ndue!

Ne jemi shokë e miq prej shumë kohë, i jemi drejtuar njeri-tjetrit thjeshtë dhe pa shume etiketa. Por në rastin e kësaj interviste do të shkeputem disi nga ajo sjellje dhe nga ky moment e deri në fund të bashkëbisedimit do të jeshë një ushtarak i lartë, një Kolonel, por shumë aktiv në jetën e përditshme edhe sot pavarësisht moshës relativisht jo të vogël.

## FËMIJA NË UDHËKRYQ - fëmijë të llastuar -

Rritja e fëmijëve është një ndër përgjegjësitë më të mëdha për secilin prind. Dëshirat e prindërve për t'ia dhënë më të mirën fëmijëve dhe të ia bëjnë jetën më të rehatshme dhe më të sigurt, por kjo sjell në shumë raste llastimin e tyre. Në të vërtetë nuk ka fëmijë të keq, por ka fëmijë të edukuar keq. Familjet në të cilat bëhet çfarë thotë fëmija, takojmë "LU" e shtëpisë". Një nga gabimet më të mëdha që bëjnë disa familje ...



## NIKË ZEF G JONI NGA LOTAJT E SHALËS, VËLLAJ I DËSHMORËS LINA ZEFI-SFIDON MOSHËN

Fshati Lotaj është i njohur për traditat patriotike, atdhetare, luftarake e arsimor, duke qene në pararojë të Dukagjinit. Në këtë truall u lindën, u edukuan dhe u shkolluan shumë bijë e bija të këtij fshati si: ushtarak, diplomat, arsimtar, inxhinier, financier, mjek e të tjerë, të cilët ishin dhe janë shumë gjurmëlënës në sektorët ku punuan. Në këtë mjedis u lind, u rrit dhe punoj pa u lodhur edhe Nikë Zefi, i cili është objekt i këtij shkrimi bashkë me të motrën dëshmore. ...

# Historia e Shkodrës dje dhe sot

Nga profesor  
Gjon Frani Ivezaj



Shkodra: qyteti që prej shekujsh njihet si djepi i kulturës dhe civilizimit të lartë brenda trojeve etnike shqiptare, prej shekujsh qëndron e gjalle e plot dinjitet i rrethuar nga vargmalet lindore me Cukalin hijerëndë, Kështjellën Legjendare “Rozafa”, Liqenin Labeat, pasurinë e pashtershme të Shkodrës si dhe fushat e tejzgjatura deri rrëzë Alpeve të Veriut. Historia e saj është e mbushur me ngritje dhe ulje ndër shekuj. Ajo gjithnjë ka qenë në qendër të vëmendjes gjatë gjithë historisë nacionale shqiptare. Shkodranët, kanë qenë ndër shekuj ndera dhe lavdia, të parë në të gjithë këndvështrimet, duke zënë në këtë mënyrë një vend nderi në histori.

Do të mundohem që të cek nga pak matjat e krenarisë së qytetit dhe të vetë banorëve të saj ndër shekuj, duke u bazuar në shumë burime historike, që janë dëshmi e mbijetesës së lavdishme të zonës dhe qytetit, të vetë banorëve vendas kulturëdashës. Shkodra, ky qytet i lashtë 2500-vjeçar, është një nga qendrat më të shquara qytetare të Shqipërisë e të gadishullit Ilirik, i njohur si kryeqendër tradicionale e kulturës shqiptare. Duke ndjerë në këmbët e saj përplasjen e dallgëve të Liqenit të Shkodrës dhe duke ndjerë në gjoks gurgullimën e lumenjve të Bunës, Drinit e Kirit, me një dorë të mbështetur në **bedenat** e kështjellës legjendare “Rozafa” dhe tjetrën në Alpet shqiptare, Shkodra të ofron bukuri të virgjëra natyrore që rrallë i has në një vend tjetër të globit. Në rrjedhë të shekujve, veç etjes së saj për liri e pavarësi, ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në rrafshin e kulturës e të artit, tradita të cilat kanë ardhur me bukurinë e tyre deri në ditët tona. Gjurmët më të hershme të veprimtarisë njerëzore të zbuluara në pellgun e Shkodrës i përkasin periudhës së paleolitit të mesëm, por duke filluar nga periudha e bronzit, ato kanë një prezencë intensive e të pandërprerë. Ky territor ka qenë i banuar nga fisi ilir i Labeatëve, lundërtarë e tregtarë të zotë. Ishin shkëmbimet tregtare me zonat e tjera që u bënë shkak për themelimin e qytetit të Shkodrës, si një treg e vendbanim ilir. Kështu, që në shekullin e IV p. K. e fillon jetën ky qytet ilir, i cili njihet në histori me emrin Scodra, Scobre, Skodrai, Skodre, Skydreonopolis-sot Shkodra. Pushtimet e ndryshme ia kanë ndërprerë zhvillimin, e kanë shkatërruar shpesh dhe nga themelet, por Shkodra është ngritur edhe nga hiri. Në afro pesë shekuj të pushtimit osman, shkëlqimi i

qytetit u venit, por në shekullin XVII do të jetë përsëri një qendër e rëndësishme, jo vetëm administrative, por edhe ekonomike e Shqipërisë. Në këtë periudhë kishte 1800 shtëpi dhe 25 000 banorë dhe gradualisht bëhet një qendër e rëndësishme kulturore. Në Shkodër lindën institucionet e para kulturore të vendit. Qyteti është themeluar në shekullin e IV para Krishtit, prej fisit të Labeatëve gjatë sundimit të **Gentit (181-168)** përreth kështjellës “Rozafa”. Zona përreth vendit ku ndodhet sot **Shkodra** ka qenë e banuar që në kohët parahistorike. Këtu janë gjetur gjurmë të paleolitit të mesëm, ndërsa që nga neoliti gërmimet kanë zbuluar vazhdimësi jetese që vjen deri në ditët tona. Objektet e gjetura gjenden në muzeumin e qytetit, në atë të Tiranës dhe në muzetë e Evropës. Kjo, sepse zona ka një kombinim të rrallë faktorësh fizikë për jetesë. Rrëzë kodrave të Tepes, në anën jugore të qytetit të sotëm, materialet arkeologjike fillojnë nga **Bronci** i hershëm (2000 para Krishtit). Në shekullin V – IV para Krishtit filloi ndërtimi i kështjellës me gurë ciklopikë të puthitur pa llaç. Kështjella është e vendosur mbi një kodër në hyrje të qytetit në një lartësi 130 m. Në atë periudhë treva banohej nga fisi Ilir i Labeatëve. Në këtë kohë qyteti merr një zhvillim ekonomik, gjë që dëshmohet nga prerja e monedhës në qytet që në vitin 230 para Krishtit. Nga monedha mësojmë emrin që ka pasur qyteti në atë kohë, Scodrinon. Në vitin 181 para Krishtit bëhet Kryeqytet i Mbretërisë së Ilirisë, me sundimtar **Gentin**, dhe kishte një shtrirje të madhe në pjesën veriore. Gjatë shekullin II para Krishtit në kështjellën e qytetit zhvillohen luftërat me Romën, në vitin 168 pushtohet nga **Roma** dhe bëhet një nga qendrat e njësive administrative të Perandorisë Romake. Me reformat e **Dioklecianit** bëhet qendër krahinore. Aty kalonin rrugë tregtare të rëndësishme drejt bregut Dalmat, nga veriu, dhe nëpërmjet luginës së Drinit për në Dardani, nga lindja. Ajo pushtohet dhe bëhet kryeqendër e shtetit të Zetës në shekullin e XI. Më pas vjen pushtimi i shkurtër bullgar. Në shekullin XIV bëhet qendër e rëndësishme



het nga **Roma** dhe bëhet një nga qendrat e njësive administrative të Perandorisë Romake. Me reformat e **Dioklecianit** bëhet qendër krahinore. Aty kalonin rrugë tregtare të rëndësishme drejt bregut Dalmat, nga veriu, dhe nëpërmjet luginës së Drinit për në Dardani, nga lindja. Ajo pushtohet dhe bëhet kryeqendër e shtetit të Zetës në shekullin e XI. Më pas vjen pushtimi i shkurtër bullgar. Në shekullin XIV bëhet qendër e rëndësishme

postale, dogane. Më **1865** kështjella braktiset, pasi **Lumi Drin** ka ndryshuar shtratin. Qyteti është kthyer në port lumor dhe tregton me botën nëpërmjet skelave ndërmjetëse si ajo e **Obotit, Shëngjinit, Ulqinit, Tivarit**. Qyteti shquhet për mjediset të gjelbëruara dhe oborret me lule. Në vitin **1878** krijohet **Lidhja e Prizrenit** për mos copëtimin e trojeve të Shqipërisë. Shkodra bëhet një vatrë e rëndësishme e lëvizjes nacionale. Ushtrinë e Shkodrës

autonome me institucione të zhvilluara dhe në vitin **1360** bëhet kryeqendër e Principatës së familjes Balshaj. Më **1396** kalon nën sundimin e Republikës së Venedikut, e cila rikonstruktonte kështjellën dhe qytetin e quan Scutari. Qyteti ka institucione dhe ligje si çdo qendër e zhvilluar veneciane në Adriatik. Mbas vdekjes së heroit nacional, **Gjergj Kastrioti**, i cili drejtoi rezistencën e popullit shqiptar ndaj pushtimit të Perandorisë Osmane, në vitin **1479** **Sulltan Mehmeti II** rrethon përsëri Shkodrën, me mbi 100 000 ushtarë, si qyteti i fundit shqiptar i pa pushtuar. Mbrojtja vazhdoi mbi shtatë muaj nga një garnizon prej 1600 vete, i cili u dorëzua me kusht. Kjo qëndresë u përshkrua nga historiani i parë shqiptar dhe dëshmitar i kësaj ngjarjeje, shkodrani françeskan humanisti **At Marin Barleti**. Libri i tij: “**Rrethimi i Shkodrës**”, u botua në Evropë në vitin **1504**. Pas pushtimit qyteti u rrënuar, por dalëngadalë u rimëkëmb dhe në shekullin e XVII u bë qendër sanxhaku e Perandorisë Osmane. Në këtë periudhë qyteti ka mbi 1800 shtëpi dhe ka filluar të shtrihet në fushën ku është sot. Zhvillohen zejtaria, punimi i armëve, punimi i mëndafshit, i bakrit dhe i stolive prej argjendi. Në shekullin XVIII bëhet qendër pashallëku nën sundimin e familjes vendase të Bushatlive. Më **1787**, **Mahmut Pasha i Bushatlive** tentoi për herë të parë krijimin e një principate të pavarur shqiptare, që më vonë u shtyp nga perandoria osmane. Më **1718** janë hapur në Shkodër agjencitë e para konsullore. Më **1730** krijohet **Dhoma e Tregtisë**. Nga viti **1807** deri me **1809** ndërtohet **Bexhisteni** në zonën tregtare në rritje të qytetit. Në shekullin e XIX rritja ekonomike ecën me ritme të larta. Qendra tregtare ose pazari ka rreth 2500 dyqane dhe është më i madhi në gadishullin Ilirik. Qyteti arrin në 50 000 banorë dhe bëhet qendër Vilajeti. Këtu prodhohen veshje tradicionale, pëlhurë, lëkurë, duhan, barut, që eksportohen. Ushtrohen 80 profesione. Në qytet janë 6 konsullata të fuqive evropiane dhe vendeve fqinje. Në vitin 1867 qyteti bëhet qendër e Arqipeshkvisë. Ka institucionet tregtare të kohës, gjykatë, drejtori

postale, dogane. Më **1865** kështjella braktiset, pasi **Lumi Drin** ka ndryshuar shtratin. Qyteti është kthyer në port lumor dhe tregton me botën nëpërmjet skelave ndërmjetëse si ajo e **Obotit, Shëngjinit, Ulqinit, Tivarit**. Qyteti shquhet për mjediset të gjelbëruara dhe oborret me lule. Në vitin **1878** krijohet **Lidhja e Prizrenit** për mos copëtimin e trojeve të Shqipërisë. Shkodra bëhet një vatrë e rëndësishme e lëvizjes nacionale. Ushtrinë e Shkodrës

luftojnë për mbrojtjen e territoreve shqiptare të **Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Ulqinit dhe Tivarit**. Fillon kështu një periudhë trazirash për qytetin, që reflektohet në rënien e shpejtë të numrit të popullsisë. Shkodranët morën pjesë aktive në luftën për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, duke luftuar me armë dhe duke nxjerrë figura të shquara udhëheqësish dhe njerëzish të pendës. Pas fillimit të luftës së parë botërore Shkodra sulmohet nga ushtritë malaziasë, të cilat më **1915** hyjnë në qytet. Në janar të **1916** pushtohet nga austriakët, të cilët e bëjnë Shkodrën qendër të zonës së tyre të pushtimit. Me mbarimin e Luftës I Botërore, në Shkodër vendoset një administratë ndërnacionale. Mbas **Kongresit të Lushnjës**, më **1920**, qyteti administrohet nga qeveria shqiptare që doli nga ky kongres. Në vitin **1945** u vendos diktatura komuniste dhe qyteti vuajti për 45 vjet nga represioni që donte ta privonte qytetin nga prirjet e tij demokratike dhe kulturore, nga marrëdhëniet me botën dhe nga ekonomia e tij tradicionale. U persekutuan personalitetet më të spikatura të qytetit. U vu dorë mbi institucionet e kulturës dhe të kultit, duke i transformuar sipas ideologjisë së re. U bë çdo gjë, që qyteti të humbiste identitetin e tij mijërvjeçar. Megjithatë ishin shkodranët që dhanë sinjalet e para në Shqipëri për rrugën e re të demokracisë, që në janar të vitit **1990**. Trashëgimia kulturore e Shkodrës për nacionalitetin Shqiptar fillon që në shekullin XV me shkrimet e para në gjuhën shqipe. Kemi në këtë qytet shkrimtarët, gjuhëtarët, historianët e parë të vendit. Në shekujt XVIII – XIX kemi institucionet e para shtetërore që pasqyrojnë lidhjet e Shkodrës me botën e qytetëruar evropiane. Për herë të parë në Shqipëri zhvillohet arti, sporti, lindin muzetë dhe bibliotekat. Fillon arti fotografik, shtypshkrimi dhe, më vonë, kinemaja dhe energjia elektrike. Firmat e fuqishme tregtare bëjnë tregti me të gjithë botën deri në **Japoni**, duke sjellë në qytet prodhime ekzotike. Në familjet shkodrane nuk mungojnë pianofortet dhe pikurat e klasikëve botërorë...

## Zanafilla e Shkodrës...

Në kohën kur popullsia ilire e territorit shqiptar kishte arritur zhvillimin më të lartë ekonomik e kulturor, në vitin 181 para Krishtit bëhet Kryeqytet i Mbretërisë Ilire. Me ndarjen e Perandorisë Romake, Shkodra, sikurse e gjithë Iliria e Jugut, kalon nën kontrollin e Bizantit, por vazhdoi të varej nga Kisha Katolike e Romës. Duke përballuar pushtimet e shumta të barbarëve, që pushtuan territoret shqiptare ndërmjet shekujve XI-XIV, Shkodra përjeton edhe një periudhë vetëqeverisjeje. Në vitin 1040 qyteti u bë kryeqendra e Zetës, qendër e rëndësishme, komune autonome me institucione të zhvilluara. Ajo në vitin 1360 bëhet kryeqendra e shtetit feudal të familjes Balshaj. Po në këtë kohë rikonstruktohet Kështjella legjendare dhe



# “KUJTIMET E NJË USHTARAKU”

## NJË JETË NË SHËRBIM TË ATDHEUT

- Bashkëbisedim me zotin Ndue Sanaj -

I dashur Ndue, mbas një pune disa vjeçare, më në fund i shkrove kujtimet e jetës dhe punës suaj ushtarake, i botove në një libër, me një paraqitje mjaft serioze, për të cilat jo pak me thoshe, se jam duke punuar të hedh në letër kujtimet e mia më mbreslënëse të jetes sime ushtarake, prej 45 viteve dhe të thosha mirë bën. Në vlerësimin tim, të them me bindje të plotë: Të lumtë mendja e dora për këtë arritje të madhe, e cila është diçka ndryshe nga botimet e zakonshme.

Zoti Ndue!

Ne jemi shokë e miq prej shumë kohë, i jemi drejtuar njeri-tjetrit thjeshtë dhe pa shume etiketa. Por në rastin e kësaj interviste do të shkeputem disi nga ajo sjellje dhe nga ky moment e deri në fund të bashkëbisedimit do të jeshë një ushtarak i lartë, një Kolonel, por shumë aktiv në jetën e përditshme edhe sot pavarësisht moshës relativisht jo të vogël.

**Tani, pasi libri doli, si e ndjejnë veten kolonel Ndue Sanaj?**

**Përgjigje:** Kisha kohë që punoja për këtë libër, po të thuash hapat e parë i kam hedhur që në vitin 2008, por shumë punova në vitet e fundit. Sigurisht mbaja një “peshe” të rëndë se, jo vetëm do të lirohesha nga ajo marrje përsipër, nga një detyrë që i kisha vu vetes, që më në fund do të botoj jetën time ushtarake, jo pak dhe të familjes sime, prej 45 viteve. Por dhe jetën e mbi 2500 personazheve, që nëpërmjet tyre, jetën e të gjithë ushtarakeve të ushtrisë shqiptare, që nga ushtari më i thjesht, që nga rezervisti, vullnetari, rinia e studenti më i thjesht dhe deri te ushtaraku i nivelit më i lart, deri te niveli i Ministrisë të Mbrojtjes, që me aq idealizëm punuan në shërbim të atdheut e popullit.

Pra, e ndjejë veten mirë, e ndjejë veten të liruar nga kjo peshë. Madje dhe më të lehtë, pas komunikimit me publikun nëpërmjet TV “Rozafa” dhe TV1-Channel, për të cilën falënderoj gazetarin Simon Shkreli e gazetaren Linda Kavaja, që ma krijuan këtë mundësi.

**Idea e realizimi është e madhe, por mendoj se është me interes të dihet, se si të lindi ideja të shkruash jetën tënde ushtarake se, nuk është lehtë, duke pasur parasysh jo vetëm një jetë të tërë, prej 45 viteve, por dhe një marrëdhënie me shumë personazhe civile e ushtarake të të gjitha niveleve?**

**Përgjigje:** I nderuar Luigj, dua të them diçka më shumë, duke filluar që në themelimin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”! Unë kam pasur mundësinë të shkruaj me dhjetëra metodika për përgatitjen e

kuadrove, të komandave e shtabeve, por edhe të trupave, që secila shkonte deri në 200 faqe dhe të shoqëruar me disa harta të shkallëve të ndryshme, sipas nivelit të stërvitjes, dhe megjithatë nuk merrja guximin të shkruaja në shtyp. Shkrimi i pare në shtyp, në gazetën “Ushtria”, e kam shkruar në muajin qershor 1995, me titull “Roli i komandantit të skuadrës”. Shoqata ishte ajo, që na nxiti të shkruajmë, duke nxjerre gazetën e saj, me emrin “Dukagjini”. Me këtë rast falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët, por në mënyrë të veçantë Luigj Shytin, Prele Milanin, Lazer Kodrën, Lulash Brigjen, Lazer Stanin e të tjerë, që në shembullin e tyre, më hipi një fare “xhelozie”, sigurisht për mirë, të shkruaj dhe unë.

Një rast, po i tregoj Mjeshtër të Madh,

“Dukagjini, Shqipëria ime aty”, publicistikë, studimin me titull “Gjurajt”, me bashkautorët Arben Gjuraq e Vat Gjoni, “Historikun e familjes Sanaj”, gradualisht i erdhi radha dhe këtij libri. Siç e theksova më lartë, herët kam filluar, por vendosur e kam pas vitit 2008 dhe më me këmbëngulje, punova në vitin 2018-2020. Një jete e tërë, 45 vite, që nga moshë 15 vjeç e deri në moshën 60 vjeç, në detyra nga më të ndryshmet, nga detyra e komandantit të skuadrës e deri në detyrën e Komandantit të Brigadës e të Shefit të Shtabit të Divizionit, punuar në shumë vende, kryesisht në Veri të vendit, që nga Salisalltiku i Krujës, Tirana, Bushati, Puka, Kelmendi, Vaudejësi, Hasi, Kukësi e Shkodra dhe në rrethinat e tij, mendova gjithë këtë jetë e punë ta hedh në letër dhe

shumë, jo thjeshtë për punën që bën, por mbi të gjitha për kurajën që më dhanë.

**Zoti kolonel, në çfarë rrethanash të lindi ideja të përzgjidhje profesionin e ushtarakut? A mund t’i parashtrohet idetë që do t’i motivonin të rinjtë për të përzgjedhur këtë profesion?**

**Përgjigje:** Në fillim, me mbarim e shkollës 7 vjeçare, nuk kisha asnjë ide për t’u bërë ushtarak. Kisha idenë, se duhet të vijohet shkolla dhe më pëlqente profesioni i mjekut. Ky profesion ishte ideja ime, dëshira ime dhe për këtë pata bere kërkesën me ndihmën e Dede Marashit, i cili ishte rreth 5 vite para meje, djalë prej Thethi e nip Gjuraq, që banonte dhe banon në Lezhë. Pasi u miratua kërkesa dhe më erdhi thirrja, që me datën 1 shtator 1958 të paraqitsha

**Kujtimet e një ushtaraku**

Ndue Sanaj

Kujtimet e një ushtaraku

Kolonel Ndue Sanaj, pas daljes në pension, së bashku me Luigj Shytin, Prele Milanin, Fran Kapajn, Fran Preçin, Miri Krojti (Sana), Prele Milanin, Zef Nikën dhe Palë Lerën, me 13 maj 2003 themeluan Shoqatën Atdhetare «Dukagjini», kryetar i së cilës është që prej asaj dite. Gjithashtu, drejton gazetën «Dukagjini», periodikun e shoqatës. Përveç punës për drejtimin e shoqatës, është marrë me studime dhe botime. Ka botuar tre libra: «Dukagjini, Shqipëria ime aty - refleksione», pjesa e parë; studimin «Gjurajt», me bashkautor Arben Gjuraq e Vat Gjoni dhe «Historikun e familjes Sanaj».

Tani del para lexuesve me librin «Kujtimet e një ushtaraku - 45 vite jetë ushtarake». Ka në dorë dhe dy vëllime të tjera, si «Dukagjini, Shqipëria ime aty», pjesa e dytë dhe «Historikun e Shoqatës Atdhetare «Dukagjini»».

Vetë shkruar origjinali

V 789928 274366 Çmimi: 1500 lekë

**Kujtimet e një ushtaraku**

45 vite jetë ushtarake

Fadil Krajes, një moment të jetës sime në Has, kur isha në detyrën e Komandantit të Brigadës... Në fund të tregimit, Mjeshtër më tha:

- Ndue pse nuk shkruan, se tregon mirë, çiltër dhe rrjedhshëm...

- Unë qesha dhe e falënderova, por vetes i thash, pse jo?! Erdha në shtëpi dhe duke biseduar me Verën, këtë takim me Mjeshtër, Vera më nxiti pak më shumë dhe më tha:

- Pasi shkruan, pse të mos shkruash dhe libër...

Pas botimit të librit të parë, me titull

nesër në një libër. Mendova të paraqes një eksperience për jetën e punën e ushtarakut, kryesisht të marrëdhënieve me njerëzit në kryerjen e detyrave, pa të cilën nuk mund të kruhet asnjë detyrë. Pastaj, pasi hodha materialin bruto dhe vendosa ta botoj, u konsultova me Kolonel Flamur Muçen, i cili pasi e lexoi, më nxiti dhe më shumë, që ta botoj librin. Në këtë mes kam ndihmesën edhe të N/kolonel Dede Zhivanit, të N/kolonel Ndoc Selimit (i cili, fatkeqësisht nuk jeton më), poetit Lazer Kodra (redaktori) dhe të profesor Gjergj Perluca, të cilët i falënderoj

në shkollën e mesme mjekësore Tiranë, ndodhi një diçka, që as nuk më shkonte në mend.

Çudia ishte: Sekretari i Parë i Komitetit të Partisë së rrethit Lezhë, Rebani Shehu, na thërret në zyrë. Ishim zgjedhur 15 vete, nder 60 nxënësve që u ishte miratuar e drejta e vijimit të shkollës, në Tiranë, sigurisht në shkollë të ndryshme. Ai na kishte thirrur, që ne të shkonim në shkollën e mesme të përgjithshme “Skënderbej”! Unë isha në listë i 15-ti. Të 14-të të paret nuk pranuan të shkonin në këtë shkollë. Na erdhi radha dhe me babën Dodë, hymë



urisht ata u larguan, dhe ata që e morën në dore ushtrinë, nuk u drejtua më me pak aftësi e përkushtim se ata, por këta kishin dhe një diçka më të veçante, se ishin më njerëzor, më me këmbë në tokë.

Pse u arrite deri në këtë mendësi arrogance?

Duhet të nxjerrim një përfundim: Në analizën time, u arrit deri në këtë mendësi primitive të marrëdhënieve me njerëzit, nga qendrimi gjatë në të njëjtën detyrë, krijonte këtë mendësi. Për ata nuk kishte mandat! Qëndronin në krye të këtyre detyrave deri në daljen në pension apo të shkelnin vijën e partisë në pushtet. Kjo mendësi ishte në gjitha strukturat e shtetit shqiptar në ato vite. Një anëtar byroje politike qëndronte deri sa dilte në pension (madje dhe deri sa nuk mund të çohesh!) apo shkelte vijën e partisë në pushtet. Po kështu ishte dhe për kryetarin e kooperativës apo për drejtorin e ndërmarrjes dhe një kryetar komitetit.

Në vitin 1999, i dërgoj Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura një letër, që në mes të tjerave i shkruaja dhe për këtë çështje: "Komandant e njësive të kishin një mandat të caktuar, për tre apo më shumë vite, por ama të kishte mandat, dhe deri te funksioni më i lartë në ushtri...". Dhe ky Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, jo vetëm që nuk më kthej përgjigje, por ja kaloi Ministrisë të Mbrojtjes, që dhe ky nuk u mor me atë çështje ... Çka tregon, se ende vijonim në të njëjtën mendësi, si në kohën e Monizmit.

**Zoti Kolonel, jeni ndalur gjatë në jetën tënde ushtarake, në të gjitha detyrat që jeni emëruar, diku më shumë, diku më pak me anët e mira dhe jo të mira. Natyrisht ato të kanë lanë më shumë mbresa dhe i keni paraqite nëpërmjet librit, por a keni momente të tjera që janë interesante për lexuesin?**

**Përgjigja:** Po, ka dhe mbresa të tjera, që nuk janë pasqyruar në libër, të cilat jo se nuk janë të rëndësishme për jetën time dhe të kolegeve, por do të duheshin, se pakut edhe 2-3 volume të tjera, në të cilat mund të shkruheshin e të botoheshin të gjitha. Vetëm jeta familjare në ushtri dhe në përgjithësi jo vetëm e familje sime, por për të gjitha familjet e ushtarakeve mund të botohet një volum i veçante. Gjithsesi mund të paraqes shkurtimisht dy momente mjaft domethënëse:

Së pari: Me rekomandim të Komitetit të Partisë së Korpunit, organizata bazë e partisë së shtabit të Brigadës do të bënte mbledhjen e radhës me rend-dite të diktuar: "Roli i anëtarëve të partisë dhe kuadrove të shtabit të Brigadës në realizimin e detyrave" dhe mbledhja do të bëhej me datën 25 dhjetor 1980.

Me datën 20 dhjetor më komunikojnë fillimin e lejes së zakonshme! Bisedoj me komisararin e Brigadës, Trimo Idrizin, sekretarin e byrosë së partisë së Brigadës, Mehmet Jaho dhe sekretarin e organizatës bazë të partisë të shtabit, Adem Mula, për këtë mbledhje, duke ju thënë: "Më është komunikuar leja e zakonshme dhe më ka filluar me datën 20 dhjetor, por në qoftë se do të vijoj lejen, do të shkoje në Shkodër dhe do ta bëj lejen pranë prindërve. Në qoftë se është e nevojshme për të qene në mbledhje, do t'ju kërkoj ta shtyjnë fillimin e lejes pas datës 26 dhjetor".

Te tre, veçanërisht Mehmeti, më thonë: -Ne, i dimë problemet që kemi, ato i kemi analizuar në linjë partie dhe komande disa herë, por pasi është porosi e veçante dhe është me të deleguar, do ta bëjmë dhe nuk kemi asgjë të veçante për të trajtuar".

Mire, ju them, - Unë nesër do të nisem për Shkodër, ju jeni tre kryesoret e organizatës dhe bëni përpjekje në këtë mbledhje dhe të mos merreni me gjera që nuk kanë vlere, nuk na çojnë asgjëkund dhe nuk do të zgjidhin gjë".

U përqaftuam ....

Me datën 3 janar 1981, në Shkodër, marr informacion mbi zhvillimin e kësaj mbledhje dhe për gjithçka ishte diskutuar e thënë në atë mbledhje, si ishte proceduar më tej pas mbledhjes. Pas mbledhjes së organizatës ishte mbledhur byroja e

në libër.

Gjate kësaj kohe, shefi i degës së zbulimit i Korpunit në Pukë I. Sh, më merre në telefon dhe pasi u pyetem, më thotë:

-Komandanti im, për një germe keni për tu dënuar!

- Shefi im, ja kthej unë, - mos u bej naiv ...!

Ai nuk e mendoi, se janë disa centrale telefonike, me centralistë, që të dëgjojnë dhe vërtetë e kishin dëgjuar. Madje njeri prej tyre kishte informuar atje ku e dinte ai ... Për këtë më thërrasin, sikur miqësisht në kafe dhe më pyesin se, çfarë më ka thënë I. Sh.?

Por, sigurisht nuk gjenin atë që donin ...

Fjala ishte, se unë e kam emrin Ndue dhe jo Nuh ..., është germa "e" dhe jo "h" ...



partisë së Brigadës, e cila kishte miratuar problematikat dhe masat që ishin marre në mbledhjen e organizatës dhe frymën e saj e kishin dërguar te efektivat e njësive. Në atë mbledhje, isha kritikuar ashpër në këto drejtime:

a) Komandanti i Brigadës, Ndueja, mashtron organizatën bazë të partisë, ndryshe thotë dhe merr angazhime e detyra në organizatë dhe ndryshe vepron në praktiken e përditshme të punës! Mashtron organizatën e partisë, një kritike mjaft e rendë!

b) Mban afër, për hatër z/komandantin për prapavijën, Murat Vukaj dhe për qëllime të këqija ...

c) Z/komandanti për prapavijën, Murat Vukaj për mangësi në punë e mashtrime e propozojnë për shkarkim nga detyra ... e të tjera e të tjera.

Mund të lindi një pyetje: Ndue çfarë u bë më tej?

Është një pyetje e drejtë, por nuk do të ndalem, se nuk ja vlen të ndalesh për këto mendësi meskine ...

Së dyti, Pas ngjarjes së jashtëzakonshme, që u dogjën katër vete në barut, më patën pezulluar, siç e kam paraqitur dhe

Pra, kishim edhe episode të këtilla, me qellim të caktuar apo nga naiviteti, është tjetër gjë ...

**Gjithë përmbajtja e librit është tërheqës, por më ka tërhequr vëmendjen një episod dhe pse i shkurtër, ju e theksoni dhe e shkruani pjese të veçante "Rikonicioni - Përnjohja në malin e Podgurit (Melit) ...". Pse ky episod shkruhet i veçante? Kaq shumë ka vlerë në jetën tuaj ushtarake?**

**Përgjigja:** Po, ky moment ka një vlere për kohen dhe mendoj edhe për sot! Pse? Në atë kohë gjithçka ishte në një vëzhgim të përhershëm, në një informacion të padiskutueshme. Prandaj, dhe ne, nëpërmjet raportimeve, në veçanti me ato mujore, gjithçka raportohej saktësisht dhe me përgjegjësi ...

Eprori apo superior i mbahet gjallë nëpërmjet raportimeve të sakta, se nëpërmjet tyre bëhet analiza e gjendjes, nxjerrën përfundimet e nevojshme, mbi bazën e të cilave merren vendime sa më të drejta në interes të tashmes dhe të ardhmes, për mbajtjen në gatishmëri në çdo kohë Ushtrinë, Forcat e Armatosura.

Ajo përnjohje ishte dhe një rastësi e

kohës. Ishte koha, kur Kosovës i ishte hequr autonomia. Ishte viti i protestave të studenteve në Kosovë. Jo pak student nga ndjekja e policisë serbe, kalonin kufirin në anën tone. Në këtë situatë, ushtria serbe afronte forca këmbësorie e tanke, çka na detyronte, të freskonim detyrat, të ripërcaktonim detyrat, që na dilnin në këtë situatë, në veçanti të përgatitshim për të përballuar ndonjë provokacion të mundshëm.

**Ju ndaleni jo pak, në një nisëm të një komandanti batalioni, që ka korrespondencë me Komandantin e Përgjithshëm, madje dhe jo pak tregoheni i ashpër në këto dy momente. Pse, ky revoltim i juaj, po ta shpreh kështu?**

**Përgjigja:** Në ato kohë, disa kuadro donin të dilnin në "sipërfaqe", dhe për këtë ju bënin letër udhëheqjes. Kjo, ten-

dence ishte dhe në terren, në jetën civile. Mirë se bënin letër, nuk kishte dhe nuk ka asnjë të keqe, po të ishte qellim mirë, për të bërë që të mobilizoheshin më shumë në realizimin e objektivave, në realizimin e detyrave të gatishmërisë. Por, jo në pak raste behësh për tu dukur, për të hy në sy të mirë eprore e të tjera e të tjera. Kështu ndodhi edhe me këtë raste, me komandantin e batalionit armatier (bam) të Cahanit. Ai, e bëri letren, por nuk punonte dhe jo vetëm ne, por edhe Aparati i Komitetit Qendror, sektori për ushtrinë ishim të shqetësuar, për mos realizimin e normave të përgatitjes e të gatishmërisë luftarake në këtë batalion. Një ditë prej ditësh, një ekip më në krye shefin e sektorit për ushtrinë, Ramadan Kamberi, erdhi drejtë e në batalion dhe e gjeti pa asnjë objektiv të realizuar. Por, këtë kuadër e mbronte ai, që kishte karrigen dhe kërkonte vetëm me mbushe barkun qyl, se të tjerat ecin me frymën e shenjte. Prandaj ishte ai revoltim imi, e i kolegeve të mi. Aq thellë shkoj çështja, sa u mblodh Komiteti i Partisë së Divizionit për të analizuar mashtrimin e këtij komandant batalioni. Pra, kjo tendencë e të du-








# GJELOSH LUCË ZORGJI U NDA NGA JETA

Sot, një burrë Shale u nda nga jeta. Gjelosh Luca, një burrë me plot gojën i mirë, birë i një familje të shkëlqyer në breza mbydhë sytë përgjithmonë. Zoti e thirri në amshim. Ashtu e deshi që të marrë pranë vetes, me trupin që lëshonte hije në male, me zërin e kthjelltë, të ëmbël por të vendosur, me ballin e lartë plot hijeshi, jo vetëm nga krenaria, por së pari nga punë e tij dhe familjes së tij në shekuj në shërbim të fshatit, fisit, krahinës dhe më gjerë. Paraardhësit e tij, Gjelosh Lucë Gila e të tjerë, të përmendur qysh motit ka menduar, folë e vepruar pa ju dridhur syri, pa ju penguar goja për të mirën e bashkëkrahinarëve të tij. Sot u rrëzue një mriz në kohën kur kishim nevojë për të edhe shumë kohë, u rrëzua e oshtima e tij u përhap gjithandej, e përcollën malet e Dukagjinit, ushtoj Thethi në të katër anët nga ky lajm për këtë burrë shumë të nderuar, të kudo gjendur sa herë i lëshohej zani. U shtri ky burrë si mrizat shkullor sepse nuk e kerseu sëmundja. Gjelosh Lucë Zorgji ishte nga ata mirza që jo radhë e lënë vendin rogë, kudo që ndodhen, por Gjeloshi ka trashëgimtarë tre djem soka, "të mirë për dokë e të mirë për okë".

Paraardhësit e tij u rreshtuan në ball të luftës dhe të punës, në ball të sofrës dhe të kuvendit, në vendin e ngjarjeve që kërkon-



in zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë, aty ku mblidheshin burrat, ku zëheshin qafat e grykat për të mos lejuar ushtritë e huaja pushtuese, turke, serbe, malazeze etj të hynin apo të kalonin nëpër Dukagjin, e Shqipëri, etj.

Ndër breza u shqua kjo derë për urti, për qetësi e tolerancë deri në kufinjët maksimal, me fjalën e vërtetë e mendimin e arsyeshëm për zgjidhjen e problemeve.

Me ndarjen nga jeta të Gjeloshit, Dukagjini humbi një burrë me cilësi e virtyte të larta. Burrë i urtë, zemër gjanë e zemer

bardhë. Ai ishte anëtar i Misionit të Pajtitimit Mbarëkombëtar Shqiptar dhe anëtar i Lidhjes Shqiptare në botë.

Gjelosh Luca do ti mungojë kuvendit, do ti mungojë sofrës e tavolinës, por mendimi i tij do të jetë i pranishëm gjithmonë aty ku duhet dhe si duhet, sepse familjet dhe njerëzit e e ditur do ti kujtojë vetë puna e tyre, shëmbulli i tyre.

Vdekja e pamëshirshme e mori, por kujtimi i tij do të jetojë në mendjen dhe zemrat e familjarëve të tij, në farë e fisin e tij, në Thethin ku u rrit, në krahinën e Dukagjinit e shumë më gjerë, të shokëve e të miqëve të tij të shumtë.

Gjelosh Luca është nipi i At Daniel Gjeçaj, fratit françeskan, i papajtuar me regjimin që u instalua në Shqipëri në mbarim të Luftës së Dytë Botrore dhe u lagua për bindjet e tij politike e fetare, por gjithmonë i shërbeu fesë dhe popullit, në veçanti ati shqiptar për ti çelur dritën e shpresës dhe besimit në zot. Për këtë familja e Gjelosh Lucës u përdoq dhe u internua për shumë vite larg vendlindjes dhe vendbanimit të tyre. Edhe internimi dhe qendrimi nën presion politiko-ekonomik-shoqëror nuk e njodhosi këtë familje, por ruajti nder e burri, mikpritje e të gjitha vlerat e mira të trashëguara nga të parët.

Për Gjeloshin si edhe për shumë e shumë familje thethjane e shqiptare të përnjekura, të burgosura, të vrara, apo të internuara, ndryshimi i regjimit politik në Shqipëri çeli një epokë të re, por asnjë herë Gjeloshi e familja e tij nuk u treguan hakmarrëse, pavarësisht vështirësive që i shkaktoi politika e kohës, por gjithmonë ishin tolerant, dashamirës dhe të pranishëm pranë të gjithëve në dasma e morte, në të mira dhe të vështira, me të gjitha mundësitë e tyre.

Lamtumira që po jepet Gjelosh Lucës bartë respekt për të dhe familjen e tij, të afërmit, bashkëfshatarët, shokë e miq të shumtë. Në këtë kohë pandemie janë shtuar vështirësitë edhe në ceremoninë mortore, sepse e kanë të pamundur një pjesëmarrje sipas dëshirës së tyre, shumë shokë e miqë, por kjo kuptohet, ndjehet dhe arsyetohet në ndergjegjen e familjarëve.

Axha i yt Gjelosh, At Danieli, do të presë e do të përcjellë për në parajsë, vendi yt i merituar.

Pushofsh në paqe Gjelosh Luca. E bekuar qoftë toka ku ti do të pushosh përgjithmonë. Do të kujtohem gjatë, shumë gjatë, nga familja, të afërmit, shokë e miqtë të shumtë, në Theth, Dukagjin e shumë më gjerë.

Luigj SHYTI

15 nëntor 2020

## DEDË TOKA ISHTE NJË MILITANT I VJETËR RRACE, POR SHOSHIN DHE DUKAGJIN E DESHTI MË SHUMË SE ÇDO PARTI!

Sot mbylli sytë përgjithmonë Dedë Marash Toka një emër i mirënjohur në Shosh, Dukagjin dhe Shkodër Kishe hyrë në segmentin fundor të jetës, por rrjedhës së saj të vrullshme, nuk ju ngatërrova neper këmbë. Jetove energjik, vital dhe i dobishëm deri në çastin e fundit kur përmbushte të gjitha detyrat e një burri me vlera. Sot në këtë ditë me diell të ëmbël vjeshte në shtegun e rrugës së amshueshme përpara i doli aktori lëvizjeve patriotike 1910. 1911, 1912, 1915 bashkëluftëtari i Luigji Gurakuqit, dhe martiri e besës shqiptare Babn Celi . Homeriku i moçëm përpara se të përqafoj me dashuri si gjyshin nipin e pyeti : - Dedusha në paç ardh si burrat ardhsh i bardhë ?!

- Qe besa si ti nuk kam mujtë me ba, por oxhakun nuk ta kam ulë por mbajt me mirësi e përteri siç e kërkujnë kohërat e reja ; - ju përgjigje Deda shkurt e saktë. Deda Marashi ishte pip i një trangu të moçëm kërrçash të vjetër dhe atdhetare tue fillue që nga Cel Mirashi, Babun Celi e gdhendur në këngë e bëma legjendare per të vijuar me të atin Marash Babunin një prej mrizave më çmuar të elitës burrnore të Shoshit, i dënuar politikish per agjitacion e propogande. Edhe nga dajat ishte nipi i deres se madhe të Bal Markut të Shalës që nder breza i ka bërë nderë Dukagjinit. Deda nuk ishte nga ata që mburrej per etërit e vet, përkundrazi ua kishe "friken" edhe atje në varr ku ishin se mos nuk ishte i denje per qenë stërnipi, nipi apo djali i tyre. Dedë Marshi nuk ishte nga ata që pranonte të rrinte as nën hijen tyre, kishte karakterin dhe ambiciet e veta prandaj krijoi portretin e vet të spikatur në mesin e breznisë së tij. U rrit me mundim por jo në mjerim, nuk pati fat të kapërcente ylberin përtej arsimit të detyruar. Qe një

aktivist shoqëror që në rini, ushtri dhe me pas në ndërmarrjet e mëdha dhe kantieret e klasës punëtore të kohës ku përfundoi arsimin e mesëm profesional, dhe arriti të



fitonte kategorinë më të lartë të mjeshtrit murator.

Deda kishte pasion leximin dhe studimin, punoi me klerik dhe intelektual të kulturuar, mësoi prej tyre por mbi të gjitha "vulli" literaturë të ndaluar dhe fitoj një bagazh të kënaqshëm që bënte diferencë jo vetëm me brezin tij por edhe me njerëz të shkolluar që nuk dilnin nga ograja e librave shkollorë. Dedë Marshi ishte njohës shumë i mirë dhe interpertues i zhdërvjelltë i Kanunit të Lekë Dukagjinit. Ai njohu saktësisht etnografinë, folklorin, dhe i historitë e ndaluara që akoma nuk janë shkundur nga pluhuri i së kaluseses. Anti konformist natyrë opozitari, qe zgjuar mbasi koka ja komandonte gojën, jo goja kokën se përndryshe do kishte renë brenda. Ka qenë Kryetare i Bashkimeve profesionale në disa HC të mëdha ku tre-

goi integritet dhe përkushtim për njerëzit e punës. Dedë Marashi e parandjeu me kohë se sistemit socialist po i vinte fundi dhe qe nder të parët që i dha të shtyme komunizmit. Sa tituj dhe dekorata janë marrë, sa rrahje gjoksesh sa e sa dokumentarë dhe reportazhe triumfuese janë shkruar . Shumë jashtëzakonisht shumë torta pushteti, tapi çifliqesh përfituan ata që flinin gjumë, fshiheshin birave ose i mbanin ison valles së vjetër kur ti fillove shtegtimin tënd idealist për demokraci. Dedë Toka është i pari anëtar PD jo vetëm në Shosh, por ne Dukagjin. Ai , dhe Gjergj Temeli janë te pret shkodrane që kanë shkuan në shtëpinë e Gramoz Pashkos dhe kanë marrë bekimin nismëtarë per krijimin e një partie re opozitare .Me 10 janar 1991 në shtëpinë e tij në fshatin Celaj krijon Seksion e pare të PD në Rrethin e Shkodrës. Kur Pjetër Arbnori, Ali Spahia i thanë se nuk ndiheshin të sigurt të bënin një gjë te tillë në Shkodër, atëherë Dedë Toka dhe Gjergj Temeli erdhën në Shosh dhe shënuan një datë në kalendarin e ngjarjeve historike te trevës se tyre . Dedë Toka më pas u bë "Patriarku" i parë demokrat i Dukagjinit. Më guxim e pasion të rrëmbyer si Lumi Kirë në kohë stuhie punoi për ngritjen strukturave të partisë se parë opozitare në Dukagjin e me gjerë. Me emrin e Dedë Tokës janë të lidhura pazgjidhshmërisht të gjitha fitoret sepektakolare të PD në Dukagjin në vitet 1991-1997. Po Dedë Tokën këto fitore ose nuk do kishin qenë ose nuk do kishin qenë kurrë në ato përmasa .Dedë Toka ishte një luftëtar energjik që luftonte vetëm për fitore, kundërshtarë i frikshëm dhe dinjitoz, autokombainer i pa përsëritshëm votash bindje, zemre, proteste dhe urrejtje, kishte gurin dhe arrën në dorë të merret funksione të lakmueshme dhe dobi-

purëse dhe nuk e bëri, prandaj mbeti rezistent si azbesti nga acideve përvëluese te pushtetit. Kishte vetedijen e vetpërfaqësim-it politik të Dukagjinit në çdo nivel gjë të cilën ja arriti në kohën kur i dëgjohej fjala . Dedë Toka qe mjeshtri i ndërtimit të një trapi të fortë dhe manovrueshëm lundrues të cilin kur doli në lumë nuk e drejtoi kurrë. Dedë Tokën politika nuk e beri pisë por nuk është faji i tij nëse politika beri pis vetën. Si detar i devotshëm partiak natyrshëm beri shumë kundërshtare por fare pak armiq. I vetmi mëkat që mundë t'i këndohet është se promovoj dhe nuk u mbylli shtegun edhe atyre që nuk e meritonin por edhe kurrë nuk i qenë mirënjohës, as nuk ja njohën e vlerësuan meritat . Si çdo luftëtar idealist u ndie i zhgënjyer dhe i pa vlersuar nga rrenegatët e pushtetit. Pas viteve 2000 në vetminë e tij politike vijoj të peshkonte në basenin e librave të tij të preferuar. U dallua si aktivist dhe dashamirë i Shoqatës Dukagjini dhe gazetës me njëjtin emër në të cilën ka botuar dhe shpalesë mendimet tij të dobishme. Dedë Toka ka bërë me pasion detyrën e misionarit, parandaluesit dhe pajtuesit të konflikteve të çdo natyre përfshi edhe faljen e gjakeve ku veproj aktivisht në gjitha trevat e veriut. Dedë Toka u largua nga kjo botë i përmbushur shpirtërisht dhe moralisht duke lenë pas familje shembullore e të mirëintegruar në SH.B.A. Jetove në një kohë kapërcimi prej një epoke në tjetrën e cila shkaktotj tallaze të frikshme, por dole faqebardhë. Sot Shoshi humbi një dashurues të madh të traditave të veta por edhe i frymës se re bashkëkohore. Pastë dritë në amshim Dedë Marsh Babuni Ju ishit një militant i vjetër rrace por Shoshin dhe Dukagjin e deshe më shumë se çdo parti!

Prelë MILANI

# ISHTE DHE MBETI MJEKU STOMATOLOG NJAC GJERGJI, MORI RRUGËN E PËRJETËSISË PAS 44 VITEVE PUNE

Cin Gjergji dhe Nusha, u bënë me djalë, me 12 korrik të vitit 1957. Përbri lumit Buna, atje në Dajçin e Bregut të Bunës, Njaci do të hidhte shtat, do të rritej e merrte mësimet e para, dhe si vëlla i tri motrave, Ganxhës, Prendes dhe Lines.

Shkollimin e dëshironte dhe e donte Njaci. Kohanikët e tij tregojnë se ishte një nxënës i shkëlqyer në të gjitha disiplinat. Nuk është e tepërt të shprehemi se Njaci pati pasion të veçantë sportin më populor në Shqipëri, atë të futbollit. Ju gëzua aderimit të tij në sportklubin modest të Dajçit të Bregut të Bunës, shtatshkurtër e i papërmbajtshëm.

Njac Gjergji në të rinjtë e vet, përveç se nxënës i zellshëm dhe futbollist me të dhëna inkurajuese, ishte dhe një artist i lindur. Mori pjese e krijoi tipa dhe karaktere në edicionet e shfaqjeve të Dajçit të Bregut të Bunës, fare i ri. Prindërit Nushe e Cin, por dhe tri motrat e Njaciit iu gëzuan kënaqësisë të birit të përkushtuar, vëllait mbështetës e njeriut që veçohet nga moshataret e vet, futbollistit të talentuar dhe aktorit të estradave amatore.

Njac Gjergji përfundon shkollën unike me rezultate solide e të konsoliduar. Është ky fakt, që ja plotëson ëndrrën e fituar vite më herët, atë të ndjekjes së studimeve mjekësore, në degën e Stomatologjisë, në Shkodër. Regjistrimi në këtë institucion mjekësor i takon vitit të largët 1972, si rezultat i arritjeve të larta në mësimet.

Nuk mund të lihet menjëherë pjesëmarrja aktive e Njac Gjergjiit në aktivitetet e larmishme që organizonte shkolla mjekësore. Vite me radhë ekipi i saj do të fitonte olimpiadën e volejbollit ndërmjet shkollave.

E veçanta qëndronte në faktin se i gjithë ekipi kishin të njëjtin emër përjashtoj Njacin: Mark Bobnaj, Mark Steraj, Mark Gega, Mark Marku, Mark Baloj ose siç quhej ekipi I Markave të mjekësorës. Njaci me shokët e klasës që i gatshëm t'ju përgjigjej thirrjeve të kohës në begatimin e bjeshkës e vrrinit të Shqipërisë të viteve

shtatëdhjetë. Dallohet si vullnetar hekur i fundit me ta do të cilësoheshin si elite e shërbimit stomatologjik në Qarkun e Shkodrës, dhe jo vetëm në nivel rajonal. Emrat e stomatologeve Sadik Bajrami, Paulin Guri, Mark Bobnaj, Vasel Marvukaj, Martin Delia, Liljana Sula dhe jo vetëm, rrezatojnë në memuarët e stomatologjisë Shkodrane e më gjere. Pas përfundimit të studimeve Njac Gjergji emërohet si stomatolog në zonën e gjere e me buke, të Vaut të Dejës.

Mësimdhënës të saj ishin autoritetet didaktike shkencore të formatit të doktorëve si Leonora Bakalli, Myzejen Cufi, Fuat Beqja, Shemsi Keraj, Fejzullah Ulqinaku, Valdet Haveri, Hasan Lacaj, Abdullah Bilali, Sheriban Llukaçi e Dhimiter Bitri, si dhe Adnan Beli, Geti Franja, Ruzhdi Berdica, Vitore Palushi e Skender Haveri. Bashkëmohatar të Njac Gjergjiit dhe ky



për katër vjet me radhë Njaci vjeli dhe shpërndau në shumë shporta respektin e mirënjohjen e qindra pacienteve të zonës. Zanatin e dentistit e përsosi dhe e vendosi në shërbim të bashkësisë dhe pjesëtareve aktiv të tij. Ne harkun e viteve nëntëdhjetë Njaci u përshtat me kushtet e kohës më të re, që sythoi në Shqipëri. Nder të parët hapi klinike dentare private. Objekti ku projektoi të ardhmen ishte një kabinet dentar, por më fisnik e më i kompletuar se simotrat.

Ky objekt ishte ngjitur me Katedralen e Shkodrës, vend i quajtur edhe Toprak i Tre Heronjve. Në këtë vend pune i 'u ofruan një lume pacientesh dhe u shpreh i gatshëm tu shërbeje në çdo orar, ditën e natën.

Në këtë pjesë të Zadrimës për katër vjet me radhë Njaci vjeli dhe shpërndau në shumë shporta respektin e mirënjohjen e qindra pacienteve të zonës. Zanatin e dentistit e përsosi dhe e vendosi në shërbim të bashkësisë dhe pjesëtareve aktiv të tij. Ne harkun e viteve nëntëdhjetë Njaci u përshtat me kushtet e kohës më të re, që sythoi në Shqipëri. Nder të parët hapi klinike dentare private. Objekti ku projektoi të ardhmen ishte një kabinet dentar, por më fisnik e më i kompletuar se simotrat.

Ky objekt ishte ngjitur me Katedralen e Shkodrës, vend i quajtur edhe Toprak i Tre Heronjve. Në këtë vend pune i 'u ofruan një lume pacientesh dhe u shpreh i gatshëm tu shërbeje në çdo orar, ditën e natën.



Për stomatologun Gjergji shëndeti i gojës ishte në krye të herës detyrë shtëpie si ikone e këtij profesionit të nderuar e të respektuar. Ai pozonte sot e gjithnjë përkrah emrave të ndritshëm të stomatologjisë Shkodrane, si profesor Osman Hoxha, Dr. i shkencave Pjeter Pepa, Dr. i shkencave Musa Bizaku, Dr. Abdullah Bilali, Qemuran Kaduku, Berhan Troshani, Shemsi Keraj, Anica Vujoshi, Balo Llukaçi, Hysni Bebeziqi, Gjovalin Prela, Shpetim e Ida Gera e shumë të tjerë.

Lista është e gjate për modelet që ndoqi Njac Gjergji. Para kohe na dha lamtumirën shoku, miku e kolegu ynë.

Familjaret e tij, veço bashkëshorten Angelina, djalin Rikardo dhe tri vajzat, Stela, Esteri dhe Orbela e kane më të thellë gropën e humbjes së traut të mbi jetesës. E kemi po aq të thellë gropën e humbjes dhe ne miqtë, koleget e shokët e klasës të Njac Gjergjiit.

Jeta është konkrete dhe i ka te dyja medaljet. Në njërin anë gjendet jeta konkrete dhe në anën tjetër amshimi. Do të thotë përjetësia.

Bashkëshorti, prindi, miku, kolegu, shoku i klasës zgjodhi rrugën e përjetësisë.

Lamtumira për ty është pak o Njac Gjergji!

**Mark BOBNAJ,**  
Stomatolog dhe studiues,  
Shkodër, 21 nëntor 2020

## Ndahet nga jeta një nder interpretuesit më të mirë të putirëve në Dukagjin

Me dhimbje të madhe mësova humbjen e Martin Kole Molla nga fshati Serme, Toplanë. Që në fëmijëri dallohet për humorin e tij në interpretimin e putirëve. Është kjo gjini e artit popullore më e preferuar në malet tona për një epokë të gjate, kur zonat malore ishin të populluara, kur mungonte DJ e grupet muzikore.

Interpretimi i putirëve krijonte një atmosferë festive në grup, përmbajtja e të cilave kishte humor të fortë, me to vihshin në loje veset e këqija, si dhe mbi mënyren e pritjes, që bënte shtëpiaku, në raste festash.

Sot kjo gjini e humorit tashme është drejte zhdukjes, nga shumë të rinjë nuk kuptohet. Ajo, është një dhunti e artit pop-

ullor të trashëguar në shekuj në trevezat malësore.

Martini me dhuntinë e tij prezantohej para të tjerëve me këtë humor të hollë. Putirët krijoheshin në çast në ambiente dasdash e në ambiente festash fetare, ku takoheshin miqtë dhe kundërshtarët e fiseve me njeri-tjetrin.

Putirët vazhdonin me orë ku nuk mungonte dhe politika, e cila vihej në lojë.

Martini pati fatin të pu-



nonte për shumë vite si punonjës i shtëpisë së kulturës, më vonë si mësues dhe më pa, s disa vite në KESH.

Ai dallohej për mendjen e hollë, duke interpretuar putirët. Janë qindra dasma, në të cilat Martini niste putirët e rakisë, në prezantimin e nuses, që kishte ardhur nga një krahinë apo fshat tjetër, dhe qëndronte në pasi. Po ashtu dhe këngën e lojës së kapuçave.

Interpretimi i tij me humor e pamje madhështore me shtatin e larte prej malësori elektrizonte të gjithë të pranishmit, duke shtuar atmosferën festive tek te pranishmit.

Martini, vitet e fundit jetoi në Shkodër ku dallohej për humorin e tij në të gjithë ditët e jetës së tij!

Me ndarjen e tij nga jeta, familja humbi njeriun e dashur dhe Dukagjini një nder interpretuesit më të dashur të këngës së putirëve.

Lamtumir Martin Kole Molla!  
I perjshem kujtimi i Juaj!

**Përgatiti Zef Nika**

# NIKË ZEF GJONI NGA LOTAJT E SHALËS, VËLLAJ I DËSHMORES LINA ZEFI-SFIDON MOSHËN

Fshati Lotaj është i njohur për traditat patriotike, atdhetare, luftarake e arsimor, duke qene në pararojë të Dukagjinit. Në këtë truall u lindën, u edukuan dhe u shkolluan shumë bijë e bija të këtij fshati si: ushtarak, diplomat, arsimtar, inxhinier, financier, mjek e të tjerë, të cilët ishin dhe janë shumë gjurmëlënës në sektorët ku punuan. Në këtë mjedis u lind, u rrit dhe punoj pa u lodhur edhe Nikë Zefi, i cili është objekt i këtij shkrimi bashkë me të motrën dëshmore. U lind në fundin e shkurtit të vitit 1935 në një familje me shumë emër, jo vetëm në Lotaj, por në gjithë Dukagjinin, djali i vetëm i Zef Hilit dhe Marë Lishes. Që në moshë të re bënte diferencën për inteligjencë, zgjuars, zhvillim fizik e mendor, i cili tërë jetën ka qënë më i zhvilluar se bashkëmohatarët e tij. Është një ndër nxënësit e parë të fshatit, që filluan rrugën e dijes, në vitin 1941, vit në të cilin u hap shkolla fillore në Lotaj, ndër të parat në Dukagjin, nën kujdesin e birit të këtij fshati – Ernest Koliqi. E përfundoj me rezultate shumë të mira duke hedhur baza të shëndosha për formimin e tij të mëtejshëm në rrugën e dijes. Gjatë gjithë jetës u shqua për vitalitet në punë, për korrektësi e përgjegjshmëri të lartë, shumë i aftë për t'i përballuar sfidat e jetës, duke ja ngritur ende më lart emrin familjes. Në bazë të aftësive të tij, Ai punoj në shumë sektor. Me formimin e ekonomive bujqësore, deri në vitin 1972 punoj në detyrën e financierit dhe të përgjegjës të sektori. Nga viti 1972 deri 1992 punoj në sektorin e tregtisë, në fillim magazinier i magazinës qendrore, ndërsa në 5 vitet e fundit, punoi në detyrën e përgjegjës të sektorit të tregtisë për gjithë Dukagjinin. Ishte shumë i përgjegjshëm për punën, korrekt, me një disiplinë të hekur, i cili për punën kurrë nuk mori vërejtjen më të vogël. Ishte shumë kërkues ndaj vetes në rrallë të parë, duke dhënë shembullin personal si dhe ndaj vartësve duke dhënë ndihmën e tij për përmirësimin e punës së tyre.

Në vitet e fundit të diktaturës u bë shumë i vështirë furnizimi i popullit me produkte ushqimore të domosdoshme. Ngjika, si bamirës e human që ishte, e dha ndihmesën e tij të pakursyer, edhe jashtë mundësive, për t'i furnizuar me produkte jetike, sidomos për raste fatkeqësish, duke marrë vlerësimin maksimal për punën e tij. Tek Nuk Zefir janë të harmonizuara vetitë e virtytet më të mirë të trashëguara, të cilat i ruan me fanatizëm, me qytetarinë që ja ka mësuar jeta. Ka qene e është bujar dhe mikpritës i pashoq. Pas, ka shtëpinë afër rrugës, që lidh Shalën me krahina të tjera të Dukagjinit, në çdo kohë ka pritë e përcjellë njerëz të ndryshëm, duke treguar një fisnikëri, që nuk e ka kush si Ai, i cili mori një emër të papërsëritshëm në këtë drejtim. Këtë e ka bërë nga shpirti e zemra e madhe e jo nga pasuria, megjithëse as pa gjë nuk është gjendur kurrë. Jo më kot thoshin se, në shtëpinë e Nikë Zefit është lehtë me hyrë e vështirë me dalë.

Kjo ka sjellë që të kenë miq e shokë të shumtë, që nga malësori më i thjeshtë e deri tek kuadrot e rangjeve të larta. Tek këta të fundit shumë herë ka ndërhy, duke shfrytëzuar njohjen, për të zgjidhur hallet e problemet që kishin shumë dukagjinat të thjeshtë e pa përkrahje. Ka qene dhe është për bashkëjetesë paqësore, duke kontribuar në shuarjen e shumë konflikteve, me që ishte njohës shumë i mirë i kanunit dhe ligjeve të shtetit, duke ju dhënë prioritet këtyre të fundit. Është një enciklopedi e gjallë, shumë studiues e kureshtar për të ditur, me një memorie për t'u pas zili, duke studiuar në detaje jo vetëm fshatin e tij, por edhe Shalën e Dukagjinin. Ka të dhëna të sakta për lëvizjen demografike të banorëve të fshatit Lotaj, ku kanë zënë vend, sa familje janë, si dhe progresin që kanë ata brenda e jashtë vendit. Me po këtë kujdes punon edhe sot duke e pasuruar çdo ditë arkivin e tij. Në këtë drejtim është i veçantë edhe pse është afër të 86-ve. Ky e sfidon moshën, duke u nisur nga paraqitja e përgatitja fizike, kujtesa fantastike e logjika e kthjellët. Çdo ditë bën dhjetëra kilometra me motor dhe nuk përton me jua dhënë ndihmesën njerëzve që ja kërkojnë. Kur e pyesin, se cili është sekret i kësaj gjendje që sfidon moshën: “Kam lëvizur shumë, nuk kam pirë kurrë duhan dhe jam ushqyer shëndetshëm!” Nika është edhe një prind shembullor. bashkë me bashkëshorten Age, e cila u nda nga jeta shpejt, lindën e rritën gjashtë fëmijë, tre djem e tre vajza, shumë të edukuar e jo problematik, në saje të kujdesit e kërkesës së llogarisë, të cilët sot kanë krijuar familjet e tyre të shëndosha brenda e jashtë vendit. Ai është krenar për fëmijët, nipat e mbesat, të cilët nuk po e lënë me i ndie mbi supe vitet duke qene zemër plot. Gjithnjë ka qene shumë aktiv në jetën politike, sociale e shoqërore. Vlerëson me objektivitet ndryshimet e sistemeve me të mirat e të këqijat e tyre dhe ruan me korrektësi marrëdhëniet me njerëzit që njeh. Dy dekadat e fundit është banor i fshatit Vrake të Malësi së Madhe, duke qene shembull në integrimin në vendbanimin e ri. Për të bërë këtë shkrim u nixta jo vetëm nga jeta shumë gjurmëlënëse e Nikë Zefit, por edhe për të sjellë në memorien tonë motrën e tij dëshmore, Lina Zefi, e cila ka mbetur në hije si në regjimin e kaluar edhe të sotmin, për të cilën ka shkruar vetëm Marash Kola, në librin e tij “Dashuri e mall për Dukagjinin”, i cili ka qene në aksion me Linën dhe në grupin e shoqërimin për sjelljen e saj në vendlindje, duke e varrosur me ceremoni shtetërore. Ishin vitet e para pas çlirimit, kur Shqipëria u kthye në një kantier të madh ndërtimi për zhdukjen e pasojave të luftës dhe rindërtimin e Shqipërisë së re. Në vitin 1947

kishte filluar ndërtimi i hekurudhës së parë shqiptare Durrës – Peqin, vepër që ju besua rinisë. Në muajin korrik të atij viti, Lina Zefi, e motra e Nikë Zefit, shkoj vullnetare në hekurudhë me shumë të tjerë, për të dhënë kontributin e saj, duke hedhur prapa krahëve mendësitë e kohës, sidomos në lidhje me mendësitë negative ndaj femrës në tërësi dhe në veçanti ndaj vajzës, duke u favorizuar edhe nga prindërit e saj, të cilët ishin më përparimtar, se të tjerët në drejtim të përkrahjes së resë dhe progresin. Ajo, kështu u bë sh-



embull për fshatin dhe gjithë Dukagjinin. Bashkëkohësit e saj tregojnë se, Lina ishte një vajzë e bukur, me një zhvillim fizik e mendor për t' u admiruar, e gjallë, e shkathët, shumë përparimtare e me nivel për moshën. Që e vogël filloj me e dhanë kontributin e saj, për t' u ardhur në ndihme prindërve për krijimin e të mirave materiale. Në aksion u dallua në punë, punëtore e ndërgjegjshme, e palodhur dhe me disiplinë të lartë. Realizonte e tejkalonte normat e objektivat, duke u bërë shembull për aksionistët e tjerë, dhe për këtë ishte shpallur disa here, me titullin “Sulmuese”.

Një ditë shtatori të atij viti, duke punuar vrullshëm shembet ura ku po punonin dhe për fat të keq, shaljanja e vogël në moshën, vetëm 15 vjeçe, por që për të fliste puna e madhe, gjeti vdekjen. Jeta e saj u këput në lulen më të mirë të rinisë. Lina Zefi dha jetën për ndërtimin e vendit të saj, duke u mbuluar me lavdi. Kur e sollën të vdekur në fshatin e lindjes, vëllai, Nika 12 vjeç dhe motra Lulë u mërzu itën shumë për humbjen e motrës së tyre, kurse nana Marë e baba Zef Hili u mbajtën e u treguan të fortë, duke shprehur edhe krenarinë që vajza e tyre dha jetën, për ndërtimin e atdheut. Përcjellja për në banesën e fundit ju bë shumë serioze nga shteti i kohës dhe gjithë Dukagjini.

Për punën e saj vetëmohuese Presidiumi i Kuvendit Popullor i kohës me dekret nr. 503, datë 06/11/1947, e dekoroi Lina Zefin, me urdhrin e punës të klasit të dytë (pas vdekjes), duke e shpallur dëshmore e Atdheut, rënë në punë e sipër, e dalluar për shpirt sulmues, duke u bërë shembull frymëzimi për vullnetarët e tjerë. Kjo solli, që duke u nisur nga akti i saj heroik, hekurudha Durrës – Peqin të përfundonte së ndërtuari para afatit. Edhe familja e saj është trajtuar si familje dëshmori moralisht dhe financiarisht. Edhe komisioni qendror i statusit “Dëshmor i Atdheut”, me vendim nr. 44, date 30/12/2004 e shpalli dhe i njohu statusin “Dëshmor i Atdheut” Lina Zef Gjonit nga fshati Lotaj Dukagjin. Pra, Dukagjini ka dy dëshmore 15 vjeçare: Lina Zefi dhe dëshmorja heroinë Shkurte Pale Vata, të cilat dhanë jetën në ndërtimin e rrugëve të hekurta, duke u bërë shembull frymëzimi për rininë e kohës, për të cilat krenohet i gjithë Dukagjini! LAVDI PER JETË HEROIZMIT TË TYRE!

Për Nikë Zefin e punën e tij flasin fjalët më të mira e vlerësimet maksimale të gjithë atyre që e njohin. Po shkruajmë mendimet e disa prej tyre:

Ndoc Grimaj –si bashkëvendindas me Niken, shkruan: Nikë Zefin e njoh që në fëmijëri e deri në ditët e sotme, Ai, ka pas një zhvillim fizik dhe mendor të admirueshëm, që bënte diferencën me moshatarët, i zgjuar dhe shumë vital. Është shumë studiues i zhytur në botën e kurioziteteve.

Katrina Fusha –kam pas fatin të punoj me Nikën, rreth tre dekada në ndërmarrjen tregtare të Dukagjinit, unë financiere e Ai magazinier e përgjegjës tregtie. Ishte shumë korrekt në punë dhe bashkëpunues. Ishte shumë i gatshëm me e dhënë ndihmën e tij dhe nuk përtonte me e kërkua ndihmën

Mirash Vidhi – vlerësim maksimal për gjithë veprimtarinë e Nikë Zefit dhe sot. Unë si drejtues ekonomie e AI drejtues tregtie kemi pasur një bashkëpunim të frytshëm e korrekt. Edhe sot vazhdojnë të shtohen fjalët e mira për të .

Paraqitëm një portret të shkurtër të jetës dhe veprimtarisë gjurmëlënëse dhe shumë e vlerësuar e Nikë Zef Gjonit nga fshati Lotaj, i krahinës së Shalës.

Dëshirojmë që ta kemi edhe shumë vite midis nesh, vital si deri tani, me kujtesë të fortë e mendje të kthjellët, duke qene modeli i malësorit që sfidon moshën dhe shembull, si përballohen vështirësitë e jetës, si përkrahet progresi e ndryshimi dhe si duhet të jenë bashkëpunimi midis njerëzve duke mos u ndalur për asnjë çast për të mësuar.

# Dr. Ahmet Osja-Mjeshtër i Madh, Ajka e Patriotizmit dhe hambari i dijeve njerëzore



Mark Bobnaj-Autori i shkrimit

Ahmet Maliq Osja vetëm fizikisht nuk është më midis nesh. Ai ishte dhe mbetet në kujtesën kolektive të shqiptarëve kurajozë si një pishtar i pashuar. Në këtë kujtesë janë gjasat se do të jetojë për një kohë të gjatë ky njeri i urtë dhe i zgjuar i qytetit të Shkodrës dhe i gjithë Shqipërisë. U nda prej nesh në një ditë kur pranvera është afër. Se do të vinte kjo ditë sekush prej nesh e dinte. Por, që të vinte aq shpejt e papritmas si një britmë në boshllëk, pak kush prej nesh e dinte. Kjo, siç merret me mend, ndodh, pasi nuk jemi të përjetshëm. Nisjen e udhëtimit për në qiell e mendonim si më të largët. Ne që e njohëm nga afër Ahmetin, njeriun që e deshëm dhe na donte aq shumë.

Ahmet Osja ishte në gjenezë patriotik unik në veprime e tipare. Gjyshi i tij humbi jetën në mbrojtje të vlerave të trojeve shqiptare, në vitin dramatik 1913. Varri i gjyshit të Ahmetit është ende në këmbë në periferi të qytetit të hershëm Shqiptar, Ulqinit heroik. Babai i Ahmetit, Maliq Osja, pati miqësi më tepër se në nivelin e kumbarisë me dy shkodranë të mëdhenj që ishin Dom Ndoc Nikaj e Dan Hasani. Personalitete të spikatura të kohës.

Ahmet Osja u lind me 25 Qershor të vitit 1939 në Luarzë të Velipojës. Fisi i tij i ka rrënjët e veta në Reç të Malësisë së Madhe. Ndoshta do të rezultonte një rastësie të bukur, që në oborin e shtëpisë së lindjes, në atë ballkon piktoresk të Velipojës gjendej një pemë e shenjtë ulliri e cila për profesorin do të ishte mbreti i bimësisë. U shkollua ose më mirë me thanë "u armatos" me dije të shumanshme. Dijet që përftoi nuk i futi në "kasafortë". I shpërndau nëpër njerëzit e shumtë që njohu, me kujdesin dhe përkushtimin e farë dhënësit të legjendës.

U njoh nga te gjithë si ekspert i prodhimit bimor në të gjithë rajonin, veçanërisht i bimës së misrit. Punoi me strukturat e mobilimit të hapësirës rurale të vendit. Preku dhe la gjurmë të pashlyera në ndenjësën e Ministrisë të Bujqësisë, në kohë për të cilat është pak të thuhet se ishin të vështira. Por, gjurmë unike la kur punoi përkrah Hysen Laçejit, si mjeshtër i përkryer i kultivimit të misrit.

Kjo bimë e traditës së popullit tonë u vesh nuse me petkat që i dha Ahmet Osja dhe nusëroi me vite e dhjetëvjeçarë në podin që i rezervoi miku ynë i pakrahasueshëm. Punën në grup Ahmeti e pati

fort përzemërt. Vallja është drithëruese për aq kohë sa të gjithë valltarët përfshihen në metamorfozën e kërcimit, -thoshte me të drejtë miku im dhe i qindra mijëra të tjerëve si unë.

Udhëtonte shpesh e shumë Prof. Ahmeti. Lodhja për të ishte një term që nuk ngjit. Atë shije pikante pati. Lodhjen, Ahmeti e quante si një "çiban" në trup të shëndetshëm që duhet të hiqet. Komunikimin me kolegët dhe jo vetëm e pati në kujtë më të lartë të maturimit. E pati pikant dhe të veçantë në gjeografinë e ngjizjes së tij. Është ky shkaku i ngutjes për ta zgjatur kohën e komunikimit me Ahmet Osjen, i kolegëve, fermerëve dhe i njerëzve të profesioneve të ndryshme. Prof. Ahmeti pati në jetën e vet aq miq e shokë sa numrat matematikorë nuk mjaftojnë për ti listuar.

Për plot gjashtë dekada ai kontribuoi si një shërbëtor i zellshëm i prodhimit bimor. Në çdo shkallë ngjiteje të bujqësisë shqiptare është ndikimi dhe mbështetja e njeriut dhe shkencëtarit të spikatur, te cilit edhe emri i fillon me germën nistore të alfabetit tonë të madhërishtë. Toka për profesionin e nderuar dhe të respektuar, është më tepër se një thesar. Nëse e duam Shqipërinë, Gjergj Kastriotin e flamurin me shkabë, -thoshte gjithnjë e shumë shpesh i sapo ndari prej nesh, ne duhet ta adhurojmë me atributin e nënës tokën shqiptare.

Patriotizmi si palca e mbijetesës së një kombi është adrenalinë për të gjithë, këmbëngulte në biseda të ndryshme, në sofra e trapeza, në fushë e malësi, Ahmet Osja. Pa ja marrë tagrat një historiani si personalitet, heroi i shkrimit tonë pozicionohej si patriot i klasit të epërm. Në krye të herës besonte tek flamuri që na për bashkon e jo tek ndasitë me minare e kompaniela. Ahmet Osja ishte një biolog, por unë i jap te gjithë drejtën vetes të them se ai ishte një historian me memorie të paimagjineshme, i cili linte në "piste" edhe personalitete të spikatura të fushës, duke njohur historinë e çdo skute të globit.

Njohja në detaje e historisë e shtrirë në hapësirë dhe në kohë, falë studimeve e hulumtimeve e bënte profesorin të shkëlqente në këtë profil. Ai ishte i të vërtetave historike e biblike me themel, në bazament e periferi. Ai njihnte shumë njerëz e shumë familje nga Vermoshi në Konispol, i mbante mend si emra, kujtonte moshën e tyre dhe artikulonte histori familjare të tyre që ishin pikante. Nuk ngurronte të fliste për gjenezën e popujve të ndryshëm deri në detaje. Ai ishte një arkiv e gjallë në mos një bibliotekë dijesh nga fusha të ndryshme. Saktësia në rrëfim tek patrioti e biologu, profesori dhe akademiku ishin brilante ku saktësia zinte kryet e vendit tek Ahmet Osja.

Kam një kurbë njohjeje prej 42 vitesh

me profesorin. Që në takimin e parë më porositi të përdorja instrumente të dijeve njerëzore, të cilat fillojnë me germën "L" që janë tri. Lapsi, letra, e libri, le të jenë tri pasuritë e tua më të mëdha, mbaj mend të më ketë thënë miku im i adhuruar. Ndërkohë profesor Osja më porositi të shkruaj gjithë jetën, nëse dëshiroja të mbetesha i gjallë. Dhe të isha dikushi në jetën e përditshme me një tubë dilemash të deshifrueshme ose jo. Unë i mbetem mirënjohës njeriut të mirë Ahmet, për këtë këshillë të vlefshme që më sugjestionon. Ndaj e kam pasur dhe e kam për nder që të shkruaj për këtë udhërrëfyes të një "specie" të rrallë.

Në këto rrethana njohja me Osjen u shndërrua në shpirtërore, vetanake e familjare. Unë e çmuj miqësinë me profesorin, si të ishte kjo një shenjtëri e njëmendet që të mbush me krenari e devocion. Ja përse midis meje dhe Osjes miqësia u shndërrua në bashkëpunim të ndërsjellë. Pikëpamjet dhe pikëtakimet tona ishin frutdhënëse. Fillimisht ne na lidhi ekzistenca e kopshtit tim i ashtuquajturit "Kopshti i Edenit". Këshillat dhe sugjerimet e mikut tim ndikuan në bërjen objekt i mediave zyrtare lokale e kombëtare të kësaj pune thellësisht shkencore dhe racionale. Osja kontribuoi si pakkush që unë të zbuloja tharmin që lidhte stomatologjinë me pemëtarinë. Ai shprehej se: Mark Bobnaj eksperimenton në kopshtin e vet po me atë pasion e këmbëngulje, siç vepron në fushën e profesionit të vet të një jetëgjatësie dhe intensive në atë të stomatologjisë.

Pjesa tjetër e lidhjes dhe e mirënjohjes për profesor Ahmet Osjen, i takon kontributit që ky i fundit ka dhënë për nipin tim profesor Zef Gjeta njëkohësisht edhe autor i një libri jetëshkrimor në përkushtim të "Mjeshtër të Madh" të Punës në Agrikulturën Shqiptare klasike e moderne. Dhe përmasat e personalitetit të Osjes nuk sosin këtu. Shkojmë përtej këtij konstatimi.

Edhe pse Ahmet Osja nuk është më midis nesh, nipi im Zef Gjeta e ndjen se ka ende detyrime të pashlyera në adresë të Mjeshtër. Mjeshtër, pra Ahmeti, i zbuloi i pari prirjet shkencore të "nxënësit" të vet dhe u bë udhërrëfyes i këtyre prirjeve që rezultojnë të jenë të rezatueshme. Ishte njeriu i parë pas nënës që e mbajti në prehër për mungesë vendi gjatë udhëtimeve nipin tim Zef Gjeta. Ndodhte kështu pasi njohja e Mjeshtër të Madh me familjen e nipit tim përfshin kurbën e 4 brezave.

Ahmet Osja mbahet mend si refuzues i privilegjeve dhe dhuratave. Jeta e tij përtej modeste ishte hyjnore Privilegji apo dhurata e vetme ishte ceremonia e organizuar nga "nxënësi" i tij Zef Gjeta, me rastin e 80

vjetorit të lindjes dhe promovimit të librit voluminoz, një enciklopedi e cila i kalon caqet e monografisë, i denjë për çdo librari prestigjiozë. Kjo ishte një simbolikë në shenjë mirënjohjeje i nxënësit për mjeshtër. Në të gjallë të vet Ahmet Osja nipin tim Zefin, e radhittë me tre fëmijët me virtyte të tij. Ndërsa mua gjithmonë duke më përkëdhelur më thirrte dajë. Profesor Ahmeti zbuloi tek Zefi prirjet e tij shkencore si nxënës dhe më pas si homologu i tij i ardhshëm. Profesori dhe akademiku Ahmet Osja ka rezervuar një mirënjohje e nderim te veçantë për banoret e malësive e ne veçanti për ata të zonës së Dukagjinit. Çmonte tek ata virtytet e shenjta që ata manifestojnë e përcjellin. Disa vite të rinise së hershme i kaloi me ta dhe midis tyre. Te shtrohesh në bisede me Ahmet Osjen për banoret kreshnike dhe stoike te hapësirës dukagjinase, verën se ai e njeh pulsën e jetës ne male qe është heroike dhe e vështire. Ne librin e madh te vlerave qe i kushtohet Ahmet Osjes, detaje jetësore janë mbresëlënëse. Respekti është ne natyrën e vet i ndërsjellët. Tre breza malësorësh dukagjinase e njohin dhe e respektonin ish-agronomin e dikurshëm te krahinës apo zonës, e me pas shkencëtarin e respektuar. Ata merrnin e jepnin dashuri e respekt për ta bere jetëgjate miqësinë e harmoninë njerëzore. Dera tije për ta gjithmonë qëndroi e hapur.

Nuk me harrohet një episod me tematike mikpritjen e treguar nga Ahmet Osja. Ishte nate dimri - nis e tregon ky i fundit: -Trokasimne dere e një kulle dhe pyesim nëse kane dëshirë te kenë me shume miq. -U përgjigj një grua 'Mire se u pruni Zoti', ajo ishte dhe një nene e vlerësuar. Burri i saj, i zoti i kullës ne Lekaj te Shalës ne Dukagjin, ishte larg me pune, por bujarinë e kishte lenë ne vatër. E zonja e shtëpisë ne moshe te grave te reja e zgjuar, shprushi me kujdes zjarrin e vatrës për te nxjerre prej andej 2 a 3 grushte me gështenja te pjekura. Ato gështenja ishin vakti i darkës për fëmijët e gruas se varfër por bujare dukagjinase. Gështenjat duhet te viheshin ne sofrën e miqve. Gruaja me takt i gri-shi fëmijët e uritur te kalonin ne skutën e gjumit. Te flinin pa darke. Komenti ne ketë rast është nul. Duke folur për asetin e mikpritjes Ahmeti shton ne bisede se gruaja malësore dukagjinase është e një dimensionit te papërsëritshëm. Ne te njëjtën kohe ajo bën punën e amvisës, mban fëmijën me te vogël ne prehër, kujdeset për gjene e gjalle, tjerr lesh ne furke e bën çorapë për ata qe janë për shteg dhe din te prese dhe te përcjelle mikun.

Ishin cilësitë dhe aftësitë e virtytshme të Ahmet Maliq Osjes që e zgjeronin rrethin e njohjes me mbështetës e bashkëpunëtorë në çdo kohë e në çdo stinë. Të thuash

se Ahmeti mbetet ajka e patriotizmit shqiptar besoj se ke qëlluar në shenjë. Miq të devotshëm të mjeshtrit ishin fermerët dhe specialistët jo vetëm të bujqësisë e blegtorisë. Rrethi i miqve dhe kontributorëve ishte më i gjere se kaq. Ishin zejtarët artizanët duar artë e plot të tjerë që gjallonin kudo ku kishte e ka tokë shqiptare e kudo ku flitet shqip.

Dijet e shumta të këtij kolosi të shqipëtarizmit, ishin "arsenal lufte" për triumfin e të vërtetave solide e të dobishme. Ai ishte dhe mbetet një biblioteke dijesh për sa kohë kjo e fundit ka rëndesën e perceptimit të thesarit të dijeve. Dijet ai i quante të dobishme e racionale vetëm kur pronësohen nga një numër përherë e më i shumtë individësh që janë banorë të hapësirave urbane apo të viseve rurale ku prodhohen dhe konsumohen të mira materiale e ka frymë mbijetese. Profesor Ahmeti ynë e i te gjithëve jepte modele pa kursim, "shpërndante ilaçe falas pa mbarim".


Ahmet Osja ynë skiconte e promovonte progres, mbante çdo ditë në memorien e vet, e porosiste të ndiqeshin nga të tjerë. Mjeshtri vibroi dhe promovoi sukses. Ai drejtoi "kroçieren" e bujqësisë shqiptare në vaktin më të trazuar që pati vendi ynë në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet. Nuk dua të zgjatem në xhevahiret që e qëndrisen lavdinë personale të Ahmet Osjes sepse rrezikohen të zbres nga kategoria e rrëfimitarit. Ua hedh mbi shpinë këtë barrë të rëndë mbështetësve dhe miqve të tij që ishin të shumtë në numër. Rrëmujën e shtatoreve në lulishte e parqe, e kritikonte heroi i këtij shkrimi. Edhe busteve u duhet dhënë vendi i tyre. Ato duhet të jenë gjallë e të flasin. Tek ne ka kakofoni të kritikueshme. E kërkoj me sy e nuk e gjej Pashko Vasën, insistonte në një bisedë tek po qëndronin në sheshin përballë Bashkisë së Shkodrës. Le ta dinë mbarë shqiptarët por edhe turistët që vijnë, se Pashko Vasa është autoritet nacional i Rilindjes Kombëtare, Ministër e Guvernator, kontributor për ndërtimin e Prefekturës së Shkodrës. Duke më treguar datën dhe numrin e llogarisë me shumën marramendëse të derdhur prej tij. Sociolog dhe autor veprash letrare. Mungon pra ai që nuk duhet të na mungojë, psherëtinte mjeshtri. Unë me shaka ja ktheja: -"Asht e jona Shqipëria, të parët na e kanë lanë. E kurrkush mos të na e prekin, se desim te tan."

Me shumë të drejtë profesorin e kujtojmë për vlerat dhe modelin që na la pas. I papërsëritshëm dhe i pazëvendësueshëm ishte ky model e të papërsëritshme janë vlerat. Kur ky ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë në disa legjislatura, refuzoi dieta e pagë suplementare. Kur ishte ministër i Agrikulturës nuk pranoi të ketë shoqërues e të mbante armë. Autoveturën më luksoze që pati dikasteri ia dhuroi Terezë Bojaxhiut sapo kjo e fundit zbriti në tokën e etërve të saj, në Shqipëri. Ai kthehej në fundjavë në familje por udhëtimin e bënte me tren nga Tirana në Shkodër e anasjelltas. Netët i kalonte në zyrë e gjumin e pakët e siglonte po aty përmbi një shtrat portativ.

Me dinjitetin që i takon shqiptarit si racë sipërore, përfaqësoi Ahmet Osja në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara vendin e vet me stoicizëm dinjitet e dinamizëm të pasqorë.

Ka kryesuar ndërkohë delegacionin shqiptar në Londër për negociata për ta kthyer arin në thesarin e Shqipërisë të grabitur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndonëse përballë me një Lord, diplomat i njohur në arenën ndërkombëtare. Ky i fundit u detyrua të nënshkruajë kapitullimin përpara profesor Ahmetit me argumentin: -"Nuk jemi të përgatitur për të vazhduar negociatat".

Në vitin e mbrapshtë 1997, kur ishte Ministër Bujqësie pret zv. Presidentin e Bankës Botërore jo në zyrë, por në fillim të shkallëve të godinës së Ministrisë, duke zbatuar kësaj kodin zakonor të atdheut të cilit i përkiste. Miku pritët tek dera e oborrit ose në hyrje të kullës së vet, insistonte të deklaronte Ahmet Osja. Kodi zakonor që zbatonte ai qëndronte mbi çdo protokoll zyrtar. Në hapje të bisedës i deklaroi mikut se: -"Jemi dy popuj komshi." Ndërkohë personaliteti botëror nga Argjentina dyshon se ishte lapsus i përkthimit. Mirëpo ministri Osja e shpjegon "komshillëkun" më argumentin se sipas alfabetit flamujtonë përkëdhelin njëri-tjetrin në organizmat ndërkombëtare. E papritura e radhës ishte kur profesori thotë se: -"bazuar tek fizionomia, gjaku dhe forma e kafkës suaj, ju paskeni gjak shqiptari". Miku i impre-



sionuar pranon konstatimin e saktë duke pohuar se gjyshi i tij ishte nga Sicilia me origjinë Shqiptare. Profesori i tregon mikut tashmë "komshi e vëlla" se jam gjenetist dhe antropolog. E papritur.

Gjatë vizitës së vitit 1999, nga autoritetet e Muzeut "Eiilson" I thuhet në shtetet e bashkuara të Amerikës, se ligjërimiti yt i dashur Ahmet na impresionoi së tepërmi. Dhe ligjërimiti është aq pikant kur drejtoresha e muzeut "Eiilson" shprehet se nga goja e shkrimtarit e patriotit Ahmet Osja ne po e njohim më mirë ish presidentin e vendit tonë. Ishte ky protagonist i vetëm që nuk lejoi copëtimin e mëtejshëm të trojeve tona. Duke ju bërë më dije se nëna e tij Maria vinte nga Peja, vendi piktoresk autokton shqiptar me origjinë nga Shala e Dukagjinit.

Nga vizita në Amerikë Ahmeti ka një kujtim ende më impresionues. Njëqind gra shkodrane dikur në shenjë mirënjohjeje, me përkujdesin e veçantë të At Gjergj Fishtës, I dhuruan presidentit Uilson portretin e tij të endur me fije mëndafshi ngjyrë të bardhë e të verdhë, me refleksë të çuditshme të përfuara nga krimbi i

mëndafshit, i cili kultivohej asokohe në Shkodër. Ky shpjegim shuan kureshtjen e drejtoreshës së muzeut, sepse nga analizat e mëparshme nuk gjendej lloji i ngjyrosësit të mëndafshit. Desha të shtoj më parë se gjatë udhëtimit drejt Rinasit sapo i pëson defekt automjeti disa kilometër larg aeroportit, gjen zgjidhjen origjinale. Niset me vrap duke shikuar orarin e fluturimit. Një kalimtar i rastësishëm i jep me zor biçikletën këtij të panjohuri për të arritur në kohë në destinacion.

Sa më sipër janë etyde të vjela nga pema e dijeve të profesorit të nderuar në biseda pambarim të zhvilluara në mjedise të ndryshme dhe të dokumentuara. Unë jam i sigurt se brezat e ardhshëm do të ndjehen krenarë për faktin e thjeshtë se: "paska qene njëherë një personalitet me vlera të papërsëritshme në këtë qytet ku jetojmë dhe ne".

Ahmet Osja u cilësua dhe u nderua me të gjitha nderet që mund ti bëhen. Nuk besoj të ketë një dytës në Shqipëri të titullit të ligjërimitit e ngjites në habitatet e përshtatshme. Për të është shkruar një libër i vëllimshëm. Ismail Kadare e konsideroi me përcaktorin impulsive profesor Ahmetin! Dritëro Agolli e përmendte shpesh për cilësi të vyera. Nënë Tereza e bekoj për të pasur shumë dritë në të gjitha jetët e mundshme për tu jetuar. Ishte njeriu i një spektri deri rrezatues, tribun i vendimit të lirë. E shkroi librin e jetës së vet me vlera autentike, thellësisht iliro-dardane dhe shqiptare.

Për të gjitha këto merita e vlera Ahmet Osja është nderuar në vitin 2009 me titullin "Mjeshtrë I Madh" nga Presidenti I Republikës. Po në këtë vit, Këshilli i bashkisë së qytetit të Shkodrës e nderon me çmimin e Mirënjohjes. Forumi i Intelktualëve shqiptarë e nderon gjithashtu me titullin prestigjioz "Intelktual i Shquar". Në vitin 2000 Ahmet Osja nderohet në Amerikë me cilësimin Outstanding Scholars of the 20-th century, IBC Cambridge CB 23 QP England. Në vitin 2010 po ashtu Ahmet Osja nderohet me çmimin "Nderi I Akademisë së Shkencave". Shoqata e Gazetarëve të Shqipërisë i jep titullin "President Nderi i Gazetarëve të Shqipërisë". Po në këtë vit shoqata atdhetare "Dukagjini" e nderon me titullin "Anëtar Nderi". Viti 2016 sjell në gjirin e Ahmet Osjes titullin e lartë "Honoris Causa" Misionar I Paqes cilësohet po në vitin 2016. Malësia e Madhe me dekoratën "Qytetar Nderi" e deklaroi Ahmet Osjen në vitin 2018. Qytetar nderi i Komunës Gruemirë cilësohet po këtë vit nga nomenklatura përkatëse. Dhe titullin "Profesor Nderi" nga universiteti Bujqësor I Tiranës iu akordua Ahmet Osjes në vitin 2019. Qendra Alpe e nderon ndërkohë po në 2019, "Njeriu I Alpeve".

Pas gjithë këtyre vlerësimeve Ahmet, nuk po mundem me të thanë Lamtumirë! Për faktin kokëfortë se ti je midis nesh. Me idealin tënd me porosinë e tua, me vullnetin e papërsëritshëm. Me shembullin vetjak që lë gjurmë. Dhe tek e mbramja me vezullimin e virtyteve që ti i pate me shumicë Ahmet!

Me fjalët fjalitë e frazat që hodha në letër skicova sado thjeshtë portretin e mikut tonë të përbashkët, yllin e mëngjesit, tonin e të agrikulturës shqiptare. Nuk mund ta lë pa përmendur urimin të cilin

ai e kishte fort për zemër "Ta kesh jetën e gjatë sa Shqipja!". Ky ishte një mesazh për shumëkënd që e njihte dhe e respektonte Ahmet Maliq Osjen. Sakaq unë uroj që të kalojnë qindra brezni shqiptonjash e kujtimi i tij të mbetet i freskët.

Profesor Osja respektonte e ngrinte në kulm magmën e dijeve të Dukagjinit, zonë në të cilën kaloi vitet e pjekurisë, duke marrë shumëçka prej tyre. Një aforizëm si "Mos vdeksh në ditën e shqyrrit" iu ngjiz në memorie. Kuptimi i asaj është të bëhesh burrë e të bësh diçka. E thënë tjetërsim: Mos vdeksh kur nuk ke vlerë! Ndërkohë unë jam i sigurt se vlerat e profesor Osjes nuk veniten, sepse ai ishte për mua e për të tjerë një institucion. Një enciklopedi mësues dhe bashkëkohës i tre brezave. Mbetem i keqardhur sepse vetëm katër ditët e fundit të qëndrimit në atë reanimacion të trishtë, u prish ajo miqësi e lidhur ndër vite aq të largëta. Unë i flisja nga zemra por përgjigjen e merrja vetëm nga "përkthimi i aparaturave", të cilat shënonin parametrat sos. Ndërkohë drejtori i spitalit doktor Ardian Dajti më rrëfehej se- "Pacientin e sotëm e njoha që kur unë flija në prehrin e tij teksa bisedonte me babën tim në orët e vona të natës."

Megjithëse fund shkurti, pranvera kishte trokitur. Lulet e para kishin çelur, por çë do mbasi data 6 maj ishte ende larg. Ajo ditë që për shumë vite profesori e promovoi dhe e organizoi në Shkodër si Dita e Luleve. Në Prefekturën e Shkodrës ju bënë të gjitha nderet. I bëri homazhe me lot në sy një popull i tanë, duke i kthyer në respekt mirënjohjen e akumuluar ndër dekada.

Ahmet Osja iku në nisje të pranverës së parakohshme. Ndoshta edhe për faktin se ikja e tij qe vërtetë e parakohshme. Në fjalën e lamtumirës profesor Zef Gjeta u shpreh ndër të tjera se "U largua nga ne Rilindësi i fundit i këtij shekulli" dhe se të gjithë shkodranët duhet ta ngushëllojmë njëri-tjetrin për këtë burrë të nderuar. Ndërsa nga fjala e historianit Profesor Moikom Zeqos veçoj: "Shkodra dhe Shqipëria do të lindin personalitete por një dytës si Ahmet Osja, zor se do të ketë!" Edhe njëherë për herë të fundit Ahmet, unë nuk po mundem me të thanë lamtumirë, se ti je përsëri mes nesh.

Ahmet Osja la një amanet për t'ia skaltur në pllakën e mermertë të banesës së fundit, të cilën profesor Gjeta e pat botuar në kooptinën e pasme të librit "Profesor Ahmet Osja - Mjeshtrë i Madh - 80 vite jetë, punë e krijimtari". "Shqipërinë nuk e bëjnë as të majtët dhe as të djathtët e bëjnë shqipëtarët! Shqipërinë nuk e bën as jugu as veriu! E bëjnë Sqipëtarët! Shqipërinë nuk e bëjnë as katolikët dhe as myslimanët! E bëjnë shqiptarët! Shqipërinë nuk e bëjnë as fshatarët dhe as qytetarët! E bëjnë shqiptarët! Shqipërinë nuk e bëjnë të shkolluarit as të pashkolluarit! E bëjnë shqiptarët!" Shqipëria është një fidan që kërkon: të mbillet në zemër, të ushqehet me shpirt e të drejtohet me mëndje. Vetëm atëherë merr kuptim ky vend!" Profesor tash po të them lamtumirë në emër të të gjithëve!

Lamtumira e fundit

Mark Bobnaj,  
Mjek Stomatolog dhe Studiuës

# SHKRUAJ... PO S'PATE LETËR, SHKRUAJI NË GUR!

- MENDIME, MBI LIBRIN "BURRAT E MALËSISË-III", ME AUTOR ILMI KURTI -

Të nderuar të pranishëm!

I nderuar Ilmi Kurti, autori i librit!

Me shumë vëmendje kam lexuar librin, me titull "Burrat e Malësisë", në tre vëllime, me autor zotin Ilmi Kurtin. Një pune e madhe dhe me mjaft përgjegjësi, se të marrësh përsipër të shkruash nuk është e lehtë, por Ilmiu duke pasur parasysh shprehjen: "Shkruaj... Po s'pate letër, shkruaj në gur!", se e shkruara mbetet, nuk fshihet, ndërsa fjalët i merr era, dhe duke kaluar vitet, dekadat e jo radhe edhe shekuj do të ketë shtesa dhe interpretime sipas këndvështrimit të njërit apo të tjetrit të çdo brezi dhe do të jetë e vështirë të të vij të ti, plotësisht e vërteta, të të vije te ti, më e mundshmeja.

Të lumtë zoti Ilmi!

Në vëllimin e trete janë 46 personazhe dhe në mes tyre 6 burrneshat, që besoj në të ardhmen po të vijoi kështu, titullin e librit do ta ndryshojë, duke i vene titullin "Burrat e burrneshat e Malësisë".

Ajo që e bën më tërheqës ta lexosh këtë libër, është paraqitja e personazheve nga më të ndryshmet në vlera, në profesione dhe në bindje politike. Nga personi më i thjeshtë dhe deri te shkencëtari apo shkencëtarja, deri dhe kuadro të larta ushtarake. Kjo ngjyrosje, i jep më shumë vlere autorit, librit dhe e bën më tërheqës leximin e tij.

Vëmendje të veçante, më tërheqën 6 burrneshat që paraqiten në këtë libër, duke filluar nga malësorja fisnike Bice Zogu-Harlicaj, Tole Tome Junçaj, Vera Tafil Ndrecaj, doktorësh e shkencave dhe deri Mjeshtren e Madhe, Drane Xhaj e

Mugades Canga, të cilat ja shtojnë vlerat autorit e librit.

Më të veçante e bëjnë këtë libër, tre personazhe ushtarake, në të cilin janë Kolonel Flamur Muça, Kolonel Vuksan Vukaj e major Mynyr Gojashi. Jo vetëm që karriera e tyre ushtarake e disa dekada ka qene brilante, por në veçanti puna e bere për të ringritur ushtrinë shqiptare pas shkatërrimit të saj, në vitin e mbrapshte 1997.

Dy here është tradhtuar ushtria, Forcat e Armatosura Shqiptare.

E para, me 6-7 prill 1939, kur komandanti i tyre, në vend që të vishte opingat e të vihesh në krye të tyre, për mbrojtjen e Shqipërisë, i mbathi ato dhe u arratis.

E dyta, në pranverën e vitit 1997, Komandanti i tyre organizoi shkatërrimin e tyre, së bashku me gjithë strukturat e shtetit, për ti shërbyer serbit, me moton "Një Shqipëri e shkatërruar, një dore e fortë e serbit në Kosovë". Madje jo vetëm kaq. U organizua fillim i luftës civile Veri-Jug. Katër vete u thirrën në Tiranë, me datën 4-5 mars 1997, N/kolonel Vuksan Vukaj, N/kolonel Dede Zhivani, N/kolonel Tahir Velia dhe kapiten I-r Gac Matia, për t'i emëruar në krye të njësisve, që kishin thirre nen arme. Këta do të merni grada të larta deri në Gjeneral për tu vu në krye të forcave mercenare, për ti çuar mish për top në drejtim të Jugut. Madje, në këto ditë, duke gdhire 6 mars 1997, erdhën katër urdhra në Divizionin e Shkodrës, për tu ngritur në kushtrim tre BrK, në Lezhë, Bushat e Koplik dhe populli nuk e zbatoi thirrjen nen arme, si dhe forcat e gatsh-

me në Vau dejës të lëviznin Shkodër-Tiranë-Përmet e Gjirokastrë. Por, këta oficer nuk pranuan të vihen në krye të efektivave mercenare, duke reflektuar një atdhetarizëm mjaft të larte. As forcat rezerviste nuk pranuan të vihen nen arme, por dhe as forcat e gatshme nuk e zbatuan urdhrin e dhënë, për të shkuar në luftë kundër shqiptareve të jugut. Ushtaraket e Divizionit, me në krye kolonel Flamurin, Vuksanin e të tjerë, gjate vitit 1998-2000 treguan jo vetëm përkushtim ndaj detyrës për të ringritur Divizionin e Shkodrës, që u ngritën tre qendra model për kohën, por treguan një intelekt, vizion dhe marrëdhënie të shkëlqyera me efektivin ushtar, nënoficer e oficer, të cilët, me qëndrim e tyre, i bënë të punojnë me një përkushtim të pa parendonjëherë. Aftësia tyre drejtuese e komandues u tregua në veçanti gjate marrjes së masave për të rrite gatishmërinë Divizionit në bashkërendim me gjithë strukturat drejtuese vendore të kohës. Madje, në afërsi të pishave të përroit të Thatë, u zhvillua një stërvitje e befasishme me gjithë forcat e gatshme të Divizionit, që i bëri fqinjët ti thërrasin mendjes, se nuk gëlltitet lehtë ky vend. Prandaj, me të drejte, autori i librit i ka vendosur në libër duke i bere nder vetes dhe librit, se kuadro të tilla ushtarak janë të radhe.

Malësia e Madhe është e madhe, se përbehet nga 9 male. Në mesjetë e hershme, në shekujt X -XII, në këto hapësira u dynd një popullsi blegtorësh nomadë të ardhur nga viset e veriut, e kryesisht nga zona e Bosnjës jugore. Me këtë rast u

formuan grupime të reja popullsie, të cilat nuk quheshin më fise, por male. Dhe e gjithë popullsia e Malësisë u nda në 12 male dhe këto male u ndanë në dy grupe: **Grupi i pare** përbehej nga Triepshi, Pipri, Kuçi, Vasojeviçi, Kelmendi, Hoti, Gruda, Shkreli e Kastrati dhe u quajte Malësia e Madhe.

**Grupi i dyte** përbehej nga Krasni-gja, Gashi dhe Bytyçi, dhe u quajte Malësia e Vogël, që sot quhet Malësia e Gjakovës.

Nga ky ekuilibër i ri, banorët e filluan të shkonin drejt një përqendrimi ekonomiko-shoqëror, politik dhe kulturorë, i cili u shpreh edhe me një emër të përbashtë, pasi i gjithë vendi u quajt "Malësi" dhe banorët "malësorë", pra u zëvendësua emërtimi Pulat (Pulti).

E theksoj këtë moment historik, se zoti Ilmi ka marre përsipër një detyre shumë të madhe, por fisnike. Burrat e burrneshat e kësaj Malësie e përberë prej 9 malesh, ka aq shumë burra e burrneshat, sa do ti duhen vëllime të tëra, për ti paraqite.

Urojmë, që Ilmiu t'ia arrijë këtij qëllimi, se nuk i mungon vullneti dhe atdasheduria.

Në mbyllje, Ilmi Kurti, urime dhe urime! Të uroj të vijoni pa u ndalur në detyrën tuaj fisnike, e cila është një shembull për të gjithë, që e quajnë veten atdhetare dhe duan të punojnë për te me shumë pasion, me shumë fisnikëri!

Ju faleminderit!

**Ndue Sanaj,**

Reç, me 28 tetor 2020

## FËMIJA NË UDHËKRYQ

- fëmijë të llastuar -

(vijon nga numri 204)

Rritja e fëmijëve është një ndër përgjegjësitë më të mëdha për secilin prind. Dëshirat e prindërve për t'ia dhënë më të mirën fëmijëve dhe të ia bëjnë jetën më të rehatshme dhe më të sigurt, por kjo sjell ne shumë raste llastimin e tyre.

Në të vërtetë nuk ka fëmijë të keq, por ka fëmijë të edukuar keq. Familjet në të cilat bëhet çfarë thotë fëmija, takojmë "LUANIN e shtëpisë". Një nga gabimet më të mëdha që bëjnë disa familje rreth edukimit të fëmijës është mendimi se fëmija do të gëzohet nëse merr atë që dëshiron. Mendime të tilla shfaqen më shumë te nënat dhe baballarët të cilët kanë pasur vështirësi ekonomike në fëmijëri. "Në kemi vuajtur, por le të mos vuajnë edhe fëmijët tanë". Qëllimi i familjeve është i mirë, por qëndrimi i tyre është i gabuar dhe ndikon keq në formimin e tyre. Në të njëjtën kohë mund të themi se fëmija të cilit i plotësohet çdo dëshirë bëhet më i pangopur, i pasjellshëm dhe mosmirënjohës. Ai nuk arrin ta prek jetën me dorën e tij por nëpërmjet të tjerëve. Jeta është "Bota e përrallave" ku ai me shkopin magjik në këtë rast prindërit apo gjyshërit

mund të arri dhe të ketë çdo gjë. Që të mos rrezikojmë duhet të respektojmë kufijtë të cilët duhen vendosur nga prindërit. Në këtë pikë, ka shumë rëndësi edhe qëndrimi i mbajtur nga prindërit përballë dëshirave të fëmijës. Prindërit duhet të jenë udhërrëfyesit e familjes. Fëmija gjithnjë ka nevojë për shembullin e të rriturve. Duhet



të dijë që nuk mund të marr çdo gjë që dëshiron në jetë, pa u përpjekur edhe vetë.

Fëmijët e llastuar kanë disa shenja daluese në krahasim me fëmijët e tjerë.

*Fëmija është i sjellshëm me të tjerët, por jo me ju.*

Fëmija mund të sillet mirë me njerëz të tjerë, por nuk shfaq asnjë mirësi me

anëtarët e tjerë të familjes. Kjo është shenjë që fëmija juaj është i llastuar.

*Fëmija nuk merr pjesë në punët e shtëpisë*

Çdo prindër është përgjegjës duhet ti ndihmojë fëmijës që të bëhet i pavarur. Në moshën 3 vjeçare, fëmijët mund të i mbledhin lojërat e tyre. Në moshën 5 vjeçare, mund të ndihmojnë me detyra të vogla. Në moshën 10 vjeçare, ata mund të ju ndihmojnë rreth kuzhinës. Nëse fëmija juaj nuk pranon edhe nëse tentoni është shenjë që është i llastuar.

*Fillojnë të qajnë për të arritur çka dëshirojnë*

Prindërit nuk duhet ta shmangin këtë shenjë të dukshme, duke ja plotësuar dëshirat. Të gjithë dinë se një sjellje e tillë është e zakonshme për fëmijët e llastuar. Në shumë raste duke parë këmbënguljen e fëmijës ne për ta "hequr qafe" se po na pengon ja plotësojmë dëshirën.

*Fëmijës nuk i pëlqen aktiviteti në shoqëri*

*Fëmijët e llastuar nuk duan që të jenë pjesëmarrës në ato lojëra apo shoqëri ku nuk mbizotërojnë si "LUANT e familjes" ata këtyre rasteve ju shmangen.*

Prindërit duhet t'i mësojnë fëmijëve është I barabartë më të tjerët, se mund te fitoj por edhe të humbas.

Fëmijëve nuk u bëjnë mirë përkëdheljet e shumta, sepse fillojnë të llastohen dhe kjo më pas bëhet shkak për një keq

edukim të fëmijës në të ardhmen. Disa nga prindërit nuk i kursejnë lumenjtë e përkëdheljeve karshi fëmijëve të tyre. U flasin ëmbëlsisht dhe nuk i kritikojnë kur duhet. Por a do të thotë kjo se ata që nuk i përkëdhelin i duan më pak fëmijët e tyre? Nga ana tjetër prindërit "e sheqerosur" që i mbulojnë fëmijët e tyre me të puthura dhe fjalët të ëmbla, do të thotë se nuk kanë siguruar respekt dhe autoritet në sytë e fëmijëve? Disa prindër mundohen të jenë të rreptë me ta, sipas tyre, kanë siguruar një mënyrë ideale për të rritur dhe edukuar një fëmijë. Asnjëra prej të dyjave nuk është e prerë. Me sa duket, të jesh prind nuk është dhe aq e thjeshtë sa duket.

Kur fëmijët janë të vegjël u kanë lezet përkëdheljet, por kur fillojnë të rriten atëherë kjo do të ishte një sjellje e tepruar. Kur fëmija fillon të rritet, me të duhet të gjesh një mënyrë tjetër komunikimi. Ti flasësh ëmbël dhe ta edukosh duke i treguar se çfarë është e drejtë dhe çfarë e gabuar, por jo ta llastosh duke mos i lënë gjë mangët dhe ai më pas të të hipë në qafë.

Fëmija tërbohë kur dëgjon "jo"? Duhet që t'i mësoni se ku janë kufijtë e sjelljes së hijshme dhe të pahijshme, sigurisht që fëmija me vaj do të tentojë të fitojë atë që dëshiron por ju duhet të qëndroni në pozitën e prindit dhe mos të dorëzoheni.

(Vijon)

**Roza Pjetri**

# KUR QENTË E GJALLË KAFSHOJNË LUANIN E VDEKUR

“Shqiptari asht’ ah,  
jo shelg me u përkulë”  
Dedë Gjo’Luli

Shikonie me vemendje, o miqtë e mi, këtë shtatore të “Heroit të Popullit” Dedë Gjo’Luli! Jo, se ju nuk e njihni, apo nuk e dini kush është Dedë Gjo’Luli,” kjo pushkë e ngrehur për Shqipërinë “, siç e quante” Babai i Kombit”, Ismail Qemali, malësorin madhështor, malësorin që na takon të gjithëve. Kësaj radhe, shikonie me kujdes vendndodhjen absurde të shtatores së Tij, brenda rrethimit të kishës së Tuzit, mes një parkingu automjetesh, por jo në qendrën e Malësisë, ashtu siç e mban vendi amë, Shqipëria, në Tiranë, në kryeqendrën e Saj për të cilën fali gjithçka pati. Ky status absurd i shtatores se Heroit vjen si denoncim ndaj vetë vëllezërve tanë malësorë, që duket kanë humbur sensin e vetvetes në atë shkallë



sa Heroin Simbol i Dinjitetit të tyre Kombëtar, prej disa vitesh, vijojnë ta mbajnë në “arrest kishë”. Në këtë kontekst, pa

mohuar kurrësi gatishmërinë e kishës, në veçanti, të Padër Pashkut, për ta vendosur në atë mjedis të privilegjuar, si relegjion, edhe pse jo i plotë për performimin e shtatores së një heroit, si Dede Gjo’Luli, me rrezatim mbarëkombëtar, gjithë kjo rrodhi, sepse llomhania turkoshake politike e Tuzit, e cila shiste gjithçka te vetvetes për një karrierë politike, për turpin e vet e paragjykoi Heroin si vrasës të “vëllezërve tanë” turq. Kam besim se do ta kuptoni rebelimin tim në shpirt; kësaj, shqip, i thonë: “Kur, qentë gjallë, kafshojnë luanin e vdekur”, do të thoshte Sartri. Le të shpresojmë se kjo tërheqje publike e vemendjes mbi statusin e vendndodhjes së shtatores së “Heroit të Popullit” Dedë Gjo’Luli, që përkon edhe me 105- vjetorin e vrasjes së Tij, të pabesë, nga ushtarët e kralj Pjetrit në Mirditë, ndërkohë që ushtarët e kralj Nikollës ekzekutonin :Heroin e Popullit”, Isa Boletini në Podgoricë,

do ta nxitë komunën e re në Tuz, e kryesuar nga z. Nikë Gjeloshaj, sikurse edhe këshillin e kësaj komune me qellimin fisnik, civil dhe patriotik, si një standard evropiantlantik, që ta korrigjojnë, me dinjitet, këtë turp që na injoron si komb, përballë armiqve tanë tradicional, të cilët vetekzistencën tonë kombëtare e patën kurdoherë si halë në sy. E thënë ndryshe besojmë që do ta vendosin shtatoren e Dedë Gjo’Lulit atje ku e meriton, në kryeqendren e Malësisë, nëTuz, ashtu sikur vendi amë, Shqipëria, shtatoren e “Heroit të Popullit” Dedë Gjo’Luli e ka vendosur prej kohësh në mes të kryeqytetit të saj, Tiranës, ku hijeshon me madhështinë e saj përkrah monumentit të “Heroit Kombëtar”, Gjergj Kastriot-Skenderbeut.

**Profesor Kadri Ujkaj,**  
anëtar i Akademisë sh/amerikane  
të Shkencave dhe Arteve, New York

## Ku po shkon Kosova?!

Ndërkohë që, pas shmangies, sui-generis, të Albin Kurtit nga kryeqeverisja e Kosovës demokratike, vetëm brenda 50 ditëve të mandatimit të tij kryeministrot, po ndiqja, në media, arrestimet kolektive të elitës së UÇK-ës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, partnerë kyç të BE-s dhe SH-BAs, në frontin e përbashkët për shkatërrimin e diktaturës genocidale serbe prej një shekulli mbi Kosovën e popullin e Saj, po më parakalonin në kujtesë masakrat serbe, nën ombrellën e Fuqive të Mëdha, mbi këtë popull të pambrojtur. Njëherësh, me këto, edhe fakti i pamohueshëm i grabitjes së territoreve shqiptare duke i garantuar “Serbisë-54800 km katrorë, Greqisë-51300 km2 dhe Malit të Zi-8400 km2 sipërfaqe territori, fill pas Kongresit të Berlinit, të cilin Fishta do ta denonconte: ”Po a ky është sheji i qytetnisë/ Me nda tokën e Shqipnisë/ Për me mbajtë këlyshët e Rusisë”(Prof. Ksenofon Kristafi, analiza ”Sovraniteti dhe tërësia territoriale në fokusin e integriteteve rajonale...”, botuar në gazetën ”Dita”, më 17.07.2020). Megjithatë, pasi nuk u mjaftuan as me gjykimin prej një shekulli të trojeve dhe të dinjitetit të një vendi të vogël dhe të një populli të martirizuar, duke abuzuar deri me tragjizmin në genin e tij, në vitin 2002, Malit të Zi dhe Maqedonisë ua kalojnë, respektivisht, 8200 dhe 1500 hektarë tokë nga territori i Kosovës, kurse Serbisë, pasi Kosovës i vihet si kusht kryesor për normalizimin e marrëdhënieve me këtë të fundit, i garantohet “mina me sahat”, “Asosacioni i 6 komunave serbe” në tërë Kosovën”, Zajednica, nënkupto shtet serb brenda shtetit të Kosovës, identike për nga misioni me Republikën Serpska në Bosnje. Megjithatë, të pangopur as me këto, Të Mëdhenjtë” bindin”, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, që me duart e veta dhe trurin e

mpirë nga diktati gjeopolitik, të votojnë kalërimin e elitës udhëheqëse të UÇK-ës së Lavdishme, krenarisë sonë mbarëkombëtare, drejt Gjykatës së Hagës, në funksion të një ekuilibri të ri, si barazpeshë mes agresorit dhe viktimës, përballë krimin genocidal serb mbi Kosovën, me synimin të garantohen interesat aktuale serbe. Asgjë aspak rastësisht: ”Dhomat e Specializuara” apo Gjykata Speciale në Kosovë, falë edhe brishtësisë së gjykat-

ave në Kosovë, ndryshe Kali i Trojës, si kalërim i interesave të të Tjerëve, po i funksionon neoskllavërimit të dinjitetit të një populli të vogël, sado i sofistikuar demokratikisht. në kontekstin e dritëhijeve të frikshme, që po shoqërojnë fatin tragjikomik të 6 kryeqetarëve kosovarë, kur asnjëri prej tyre nuk guxoi të gëzojë të plotë manadatin qeverisës, që ia besoi populli i Kosovës. Ndërkohë që Serbia është pranë anëtarësimit në BE, kurse kosovarët

nuk gëzojnë as të drejtën e lëvizjes së lirë, si qytetarë të Kosovës, në BE, natyrshëm lind pyetja: Ku po shkon Kosova?!

**Profesor Kadri Ujkaj,**  
anëtar i Akademisë sh/amerikane  
të Shkencave dhe Arteve,  
New York





Prekali turistik



Mësues dhe nxënës të shkollës Theth 1957



Pishë mbi një gur midis lumit, poshtë Urës së Kolajve në Theth, foto e vitit 1976, por nuk e dimë se kujt "i zuni rrugën" dhe pas pak kohe u pre për të bërë një shtyllë, ndoshta, për te vene kashten e misrit...

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**Nikolin Gjeloshi, Itali**

